



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 6 regjistër (JR)  
Datë 03.02.2023

Nr. 63 i vendimit  
Datë 29.07.2025

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– shpalli në seancë gjyqësore publike, ditën e martë, më datë 29.07.2025, në orën 14:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 6/2023 (JR), datë 03.02.2023, që i përket:

**ANKUESE:** Komisionerja Publike Irena Nino.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 598, datë 13.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Genci Mane.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e Komisioneres Publike Irena Nino, të paraqitura në ankim, si dhe parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të

paraqitura nga përfaqësuesi me autorizim i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Adnan Xholi<sup>1</sup>, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 598, datë 13.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Genci Mane; shqyrtoi parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Genci Mane (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1 ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pas procedurës së kontrollit të plotë për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Genci Mane, ka dërguar në Komision një raport, në të cilin ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja, në përputhje me kërkesat e nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin për subjektin e rivlerësimit Genci Mane, i deklasifikuar plotësisht, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

2.3 KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në përfundim, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 598, datë 13.12.2022, lidhur me të tri kriteret e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Genci Mane, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, pasi ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit: a) *ka kryer*

<sup>1</sup> Sipas autorizimit “Për përfaqësimin e çështjes në seancë publike”, nr. {\*\*\*} prot., datë 18.06.2025.

*deklarim të mjaftueshëm dhe, në vlerësim tërësor të saktë të pasurisë, duke konstatuar pasaktësi të karakterit minimal; b) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; c) lidhur me kriterin e aftësive profesionale, ka arritur nivel kualifikues, në kuptim të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*

### **III. Shkaqet e ankimit të Komisioneres Publike**

4. Komisionerja Publike, mbështetur në kompetencën kushtetuese dhe ligjore, ka ushtruar ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 598, datë 13.12.2022, duke konstatuar se, nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenueshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Komisionerja Publike ndan gjykim të kundërt me Komisionin, pasi vlerëson se, ndryshe nga sa disponon Komisioni, për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
5. Në ankimin drejtuar Kolegjit, Komisionerja Publike ka parashtruar shkaqet e ankimit për kriteret e rivlerësimit si në vijim:

*5.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisionerja Publike ankimon konkluzionet e Komisionit lidhur me burimet për blerjen e apartamentit 140 m<sup>2</sup>, në Fier, si dhe sjell në vëmendje të Kolegjit disa rrethana faktike që kanë lidhje me këtë apartament, konkretisht:*

*5.1.1 Subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë që prindërit e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i dhënë shumën 1.700.000 lekë në vitin 2013 dhe, si rezultat, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën e këstit në vitin 2013, në shumën 1.650.000 lekë, për blerjen e apartamentit në Fier. Në analizën e Komisionit, nuk rezulton të jetë përfshirë investimi i kryer nga prindërit e subjektit për blerjen e një apartamenti tjetër në Tiranë në vitin 2004, në vlerën 61.946 euro, çka do të sillte pamjaftueshmëri në vlerën e blerjes së apartamentit.*

*5.1.2 Lidhur me pasurinë “apartament” në Fier, rezultojnë edhe disa rrethana faktike të dala nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, si më poshtë:*

*(i) Subjekti i rivlerësimit rezulton bashkëpronar në pasuritë me nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}, në Berat, së bashku me prindërit dhe vëllanë, pas rivlerësimit të së cilave në vitin 2017, pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit llogaritet në vlerën 653.697 lekë. Pra, subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë marrë nga prindërit e tij një vlerë disa herë më të lartë se vlera e tregut për pjesën e tij takuese, por pa vërtetuar mënyrën e kalimit të kësaj shume.*

*(ii) Sikurse është konstatuar edhe nga Komisioni, apartamenti me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>, i blerë nga subjekti në vitin 2013, sipas Entit Kombëtar të Banesave, llogaritet në vlerën 8.534.610 lekë, ndërsa subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë pasuri në vlerën 4.650.000 lekë, pra më pak se vlera e tregut.*

*(iii) Bazuar në aktet e administruara në Komision rezulton se subjekti i rivlerësimit ka paguar këstin e parë për blerjen e apartamentit në Fier më 02.03.2013, që daton pas lidhjes së kontratës së shitjes (nr. {\*\*\*}, datë 04.02.2013) dhe bie në kundërshtim me deklarinimin e subjektit në*

deklaratën e pasurisë të vitit 2009, ku është deklaruar pagesa në vlerën 100.000 lekë. Kjo shumë duhet të merret në konsideratë në analizën financiare të pagesave të subjektit për apartamentin.

(iv) Gjithashtu, nga të dhënat e administruara në Komision nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, rezulton se: (i) me gjeneralitetet Genci Sh. Mane, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. {\*\*\*}, në instancën Fier, dhe (ii) me gjeneralitetet Genci Mane (pa atësi) identifikohet një abonent me kontratë të furnizimit nr. {\*\*\*}, në instancën Fier. Nga aktet në dosje, konstatohet se nuk është hetuar/kërkuar informacion në lidhje me kontrata të furnizimit midis subjektit dhe personave të lidhur, me Shoqërinë e Ujësjellës-Kanalizime ShA Fier.

(v) Lidhur me kredinë e miratuar nga BKT, dega Fier, për subjektin e rivlerësimit, arsyetimi i Komisionit është përqendruar në referencë të vendimit nr. 600, datë 01.09.2007, të Këshillit të Ministrave: *“Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”*, ndërkohë që miratimi i kredisë është në kuadër të projektit të të pastrehëve të Bashkisë Fier.

5.1.3 Komisionerja Publike çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm, për sa parashikon neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me mosdeklarimin e interesit pasuror në formën e përdorimit të disa automjeteve, situatë kjo që, po ashtu, afekton edhe vlerësimin e standardit të integritetit dhe etikës së magjistratit prokuror.

5.2. *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, Komisionerja Publike, duke iu referuar dy procedimeve penale të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, parashtron në ankim se mangësitë e konstatuara në këtë kriter duhen vlerësuar së bashku me problematikat e vërejtura në kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të cilat mund të çojnë në një vlerësim të ndryshëm me atë të arritur nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

6. Komisionerja Publike ka kërkuar nga Kolegji që, në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ngritura në ankim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë ndryshimin e vendimit objekt ankimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Genci Mane.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

##### **A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit**

###### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

7. Lidhur me juridiksionin e Kolegjit, bazuar në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, që kanë për objekt rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.

Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

*b) Legjitimimi i ankuesit*

8. Komisionerja Publike, si përfaqësuese e interesit publik në kryerjen e këtij procesi, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për të drejtën e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Komisionerja Publike legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar brenda afatit ligjor 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 24.06.2025, 14.07.2025, 24.07.2025 dhe 29.07.2025.
10. Trupi gjykues, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të Institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, në seancën gjyqësore të datës 24.06.2025, vendosi kalimin procedural nga Komisionerja Publike te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
11. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, në seancën e datës 24.06.2025, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkë me parashtrimet<sup>2</sup> edhe disa akte shkresore, të cilat ka kërkuar të merren në cilësinë e provës.<sup>3</sup> Trupi gjykues i Kolegjit, në këtë seancë, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të pranojë në cilësinë e provës, nën dritën e nenit F, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, dy kontratat noteriale të dhurimit dhe shkresën nr. {\*\*\*}, datë 07.05.2025, të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Fier, si dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancë. Për kontratat e shitblerjes së apartamenteve, me palë shitëse shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në kushtet kur ato janë të administruara në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues vlerësoi se nuk është e nevojshme që të administrohen sërish, ndërsa akti i ekspertimit financiar u konsiderua si pjesë përbërëse e parashtrimeve. Gjithashtu, trupi gjykues vendosi: (i) t’i drejtohet Furnizuesit të Shërbimit Universal Tiranë (në vijim “FShU”), dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, (në vijim

---

<sup>2</sup> Subjekti i rivlerësimit paraqiti me parashtrimet e datës 24.06.2025, aktet si vijojnë: (i) Akt ekspertimi financiar, i përgatitur nga eksperti I. D., datë 13.06.2025; (ii) Kontratë noteriale dhurimi nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.02.2024, dhe kontratë noteriale dhurimi, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 04.04.2024, të vërtetuara njësisht me origjinalin, me aktin noterial nr. {\*\*\*}, datë 02.06.2025; (iii) 10 kontrata shitblerjeje, me palë shitëse shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, të njësuara me aktin noterial nr. {\*\*\*}, datë 16.06.2025; (iv) Shkresë nr. {\*\*\*}, datë 07.05.2025, e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes Drejtoria Rajonale Fier.

<sup>3</sup> Gjatë shqyrtimit gjyqësor, në seancën gjyqësore publike të datës 24.06.2025, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet si vijojnë: (i) Vërtetim nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. {\*\*\*} prot., datë 23.06.2025; (ii) Vërtetim nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, datë 23.06.2025; (iii) Shkresa e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Njoftim vendimi”, nr. {\*\*\*} prot., datë 20.05.2022.

“OSShEE”), Drejtoria Rajonale Fier, për të marrë një informacion lidhur me historikun e abonentëve për kontratën me nr. {\*\*\*}, dhe abonentëve/kontratave të tjera të mundshme për këtë njësi, si dhe paraqitjen e akteve në bazë të të cilave janë lidhur këto kontrata; (ii) t’i drejtohet shoqërisë të Ujësjiellës-Kanalizime ShA (në vijim “UK”) Fier, për kontrata të furnizimit me ujë në emër të subjektit Genci Sh. Mane, si dhe kontrata të furnizimit me ujë të kësaj njësie, që rezulton nga kontrata e sjellë, sipas informacionit nga FShU-ja, si dhe me aktet në bazë të të cilave ato janë lidhur. Pas administrimit nga Kolegji, përgjigjet e subjekteve të cituara më sipër<sup>4</sup> iu dërguan për dijeni palëve pjesëmarrëse në proces. Në seancën e radhës, të datës 14.07.2025, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kërkoi nga Kolegji vijimin e hetimit gjyqësor dhe kërkimin e një informacioni të detajuar lidhur me historikun e abonentëve për kontratën e furnizimit me energji elektrike, me nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, në kabinën “{\*\*\*}”, në instancën Fier, të abonentëve/kontratave të tjera të mundshme që i korrespondojnë kësaj njësie, para dhe pas kontratës së specifikuar më sipër, si dhe kopje të kontratave, dhe akteve në bazë të të cilave janë lidhur ato. Ky informacion u administrua nga Kolegji nëpërmjet shkresave nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2025 të FShU-së, nr. {\*\*\*} prot., datë 21.07.2025, të OSShEE-së, dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 21.07.2025, të UK-së Fier, të cilat iu përcollën për dijeni palëve.

12. Në Kolegji, pas regjistrimit të çështjes objekt gjykimi, janë administruar disa denoncime që i adresoheshin subjektit të rivlerësimit, të depozituara nga denoncuesit L. Z.<sup>5</sup> dhe G. T.<sup>6</sup>. Këto denoncime Kolegji ia vuri në dispozicion subjektit të rivlerësimit dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Në seancën gjyqësore të datës 24.06.2025, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet lidhur me denoncimet e ardhura në adresë të Kolegjit, shoqëruar edhe me aktet përkatëse. Trupi gjykues, pasi u njoh dhe shqyrtoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe aktet e paraqitura në mbështetje të tyre, duke marrë në konsideratë edhe qëndrimin e shprehur të përfaqësuesit të autorizuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se denoncimet nuk përmbajnë shkaqe për hetime të mëtejshme, vlerësoi se informacioni i përcjellë nëpërmjet tyre nuk plotësonte kriteret e parashikuara nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016, e për pasojë, vendosi të mos vijojë me hetimin e mëtejshëm të tyre.
13. Në seancën gjyqësore publike të datës 24.07.2025, në konkluzionet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke u qëndruar shkaqeve të ankimit të Komisioneres Publike, kërkoi nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 598, datë 13.12.2022, të Komisionit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Genci Mane. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit nr. 598, datë 13.12.2022, të Komisionit.

### ***B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit të Komisioneres Publike***

14. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues, pasi analizoi shkaqet e ankimit, parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, parashtrimet dhe konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi shqyrtoi

---

<sup>4</sup> Nëpërmjet shkresave nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2025 të FShU-së, nr. {\*\*\*} prot., datë 21.07.2025, të OSShEE-së, dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 21.07.2025, të UK Fier, të cilat iu përcollën për dijeni palëve.

<sup>5</sup> Administruar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2018, nr. {\*\*\*} prot., datë 07.05.2019, dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 08.07.2024.

<sup>6</sup> Administruar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 25.06.2020, nr. {\*\*\*} prot., datë 09.10.2020, dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 16.10.2020.

provat e administruara në dosjen gjyqësore gjatë hetimit administrativ dhe atij gjyqësor, duke i vlerësuar këto të fundit në raport me kërkesat e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimet e mëposhtme.

***B/1 Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë***

*- Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>”, në Fier*

15. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e Komisioneres Publike se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën e këstit në shumën 1.650.000 lekë për blerjen e apartamentit në Fier, pasi subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë që prindërit e tij kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë shumën 1.700.000 lekë në vitin 2013.
16. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, mbajti të njëjtin qëndrim si në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, duke parashtruar se prindërit e tij kanë pasur mundësi financiare për t'i dhënë shumën prej 1.700.000 lekësh si kompensim të shitjes së pjesës së tij takuese të apartamentit në Berat, e materializuar me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.02.2013. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se këto para i janë dhënë *cash* dhe, po në këtë formë, i janë paguar dhe shoqërisë ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK, sipas mandatarëtimit të depozituar në Komision. Subjekti i rivlerësimit, referuar aktekspertimit financiar të datës 13.06.2025, të sjellë prej tij bashkë me parashtrimet në Kolegj, ka pretenduar se, nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve të prindërve të tij për periudhën mars 2004 – dhjetor 2012, rezulton një bilanc pozitiv prej 3.258.920 lekësh, që provon aftësinë reale të prindërve për të kontribuar në blerjen e apartamentit.
17. Nga analizimi i akteve të administruara gjatë hetimit në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues, lidhur me këtë pasuri, konstatoi si vijon.
18. Komisioni, në vendimin objekt shqyrtimi për pasurinë “apartament me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>”, në Fier, ka konkluduar se nuk u konstatuan problematika, pasi prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi financiare nga burime të ligjshme për dhënien e shumës 1.700.000 lekë, për pagesën e këstit të parë. Sipas Komisionit, veprimet e subjektit dhe prindërve të tij për shitblerjen e pjesës takuese në apartamentin e ndodhur në Berat nuk kanë qenë veprime fiktive, por veprime juridike të kryera midis tyre, për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare. Nga analiza financiare e kryer në Komision, lidhur me mundësinë e pagesës së këstit prej 1.650.000 lekësh, në vitin 2013, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e këstit të apartamentit, shtimin e likuiditeteve dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën në fjalë.
19. Në përgjigje të pretendimeve të ngritura për këtë shkak ankimi nga Komisionerja Publike, të cilat, në tërësinë e tyre, në thelb, analizojnë dhe vlerësojnë vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për burimet reale të krijimit të kësaj pasurie dhe ligjshmërinë e tyre, Kolegji shqyrtoi deklaratimet e tij dhe të personit të lidhur për këtë pasuri, si dhe verifikoi mundësinë e tyre për të krijuar me burime të ligjshme pagesën e këstit të parë, në shumën prej 1.650.000 lekësh, për blerjen e apartamentit.

20. Nga verifikimi i akteve të administruara përgjatë procesit të rivlerësimit, rezulton se, në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Banesë me sip. 140 m<sup>2</sup> në lagjen ‘{\*\*\*}’, Fier, + 15 m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët. Burimi i krijimit: Kredi në Bankën Kombëtare Tregtare, në shumën 2.900.000 lekë. Deklarata noteriale për shitjen e pjesës takuese, banesë e përbashkët ndodhur në Lagjen ‘{\*\*\*}’, Berat, të pasurisë me nr. {\*\*\*}, sip. 82 m<sup>2</sup> dhe {\*\*\*}, sip. 57 m<sup>2</sup>, në shumën 1.700.000 lekë, dhe kursimet nga paga. Vlera: 4.650.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*”.
21. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Pagesa e kështit të parë në kontratën e shitjes së sendit në të ardhmen, për blerjen e një apartamenti në lagjen ‘{\*\*\*}’, Fier, në shumën 4.650.000 lekë, nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 17.9.2009. Vlera 100.000 lekë*”. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament banimi në lagjen ‘{\*\*\*}’, Fier, sip. 140 m<sup>2</sup> + sip. e përbashkët 15 m<sup>2</sup>. Burimi i krijimit: Kredi në Bankën Kombëtare Tregtare, në shumën 2.900.000 lekë. Shitje e pjesës takuese, banesë e përbashkët ndodhur në lagjen ‘{\*\*\*}’, Berat, të pasurisë me nr. {\*\*\*}, sip. 82 m<sup>2</sup>, dhe {\*\*\*}, sip. 57 m<sup>2</sup>, në shumën 1.700.000 lekë. Vlera: 4.650.000 lekë*”.
22. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision dy kontrata shitblerjeje me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, lidhur me këtë pasuri. Në kontratën e parë, nr. {\*\*\*} kol., nr. {\*\*\*} rep., datë 17.09.2009, të shitjes së sendit në të ardhmen, palët bien dakord që, për apartamentin me sipërfaqe 155 m<sup>2</sup>, vlera e shitblerjes të jetë 30.000 lekë për m<sup>2</sup>. Sipas kësaj kontrate, likuidimi i vlerës së blerjes do të bëhet në katër këste dhe, në ditën e lidhjes së kontratës, subjekti i rivlerësimit i ka paguar palës shitëse në *cash* një shumë prej 100.000 lekësh (kësti i parë), dhe ka marrë në dorëzim apartamentin e përfunduar në shtator 2009. Sipas kontratës së dytë, nr. {\*\*\*} / rep. / kol., datë 04.02.2013, të shitjes së pasurisë, me kusht kreditimi nga banka, subjekti i rivlerësimit përfiton apartamentin me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>, me vlerë 4.650.000 lekë. Sipas kësaj kontrate, vlera e shitblerjes së apartamentit do të lëvrohet: (i) kësti i parë në masën 1.750.000 lekë, paguar nga pala blerëse para nënshkrimit të kontratës; (ii) kësti i dytë, në masën 2.900.000 lekë, do të paguhet përmes një kredie bankare të miratuar nga Banka Kombëtare Tregtare, në favor të palës blerëse, disbursuar në llogarinë bankare të palës shitëse.
23. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, ka deklaruar se shuma prej 1.700.000 lekësh e përdorur prej tij si burim për pagesën e kështit të parë të apartamentit, është përfituar sipas deklaratës noteriale për shitjen e pjesës takuese të pasurisë me nr. {\*\*\*}, me sipërfaqe 82 m<sup>2</sup> dhe {\*\*\*}, me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup> (“banesë dhe truall”), pasuri e përbashkët me prindërit, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Berat.
24. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}rep./kol., datë 01.02.2013, sipas së cilës, ai ka deklaruar se, në cilësinë e bashkëpronarit mbi pasuritë me nr. {\*\*\*}dhe nr. {\*\*\*}, pjesën takuese mbi këto pasuri, premtion t’ia kalojë në pronësi, në mënyrë të barabartë dhe të pandarë, prindërve të tij, kundrejt vlerës 1.700.000 lekë, të cilën e ka marrë në dorëzim nga prindërit në datën e lidhjes së kësaj marrëveshjeje. Bashkëlidhur pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe mandatarkëtimin nr. {\*\*\*}, datë 02.03.2013, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, për pagesën e kështit të parë në vlerën 1.750.000 lekë.
25. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe një deklaratë tjetër të prindërve të tij, të datës 18.04.2016, në të cilën ata konfirmojnë edhe njëherë se i kanë

blerë djalit të tyre pjesën e tij takuese për apartamentin dhe pasurinë “truall 57 m<sup>2</sup>”, në Berat, kundrejt vlerës 1.700.000 lekë. Gjithashtu, prindërit deklarojnë se veprimet përkatëse në ZVRPP-në Berat për kalimin e pronësisë nuk janë kryer, për shkak të disa mosmarrëveshjeve me bashkëpronarin, djalin tjetër të tyre.

26. Komisioni, në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 3, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të deklarojë dhe provojë mundësitë financiare të prindërve për dhënien e shumës prej 1.700.000 lekësh. Në përgjigje të pyetësorëve, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se të ardhurat e prindërve nga pensioni kanë qenë në shumat 3.560.719 lekë dhe 5.342.335 lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se babai i tij ka qenë i punësuar pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën shtator 2007 – nëntor 2012, gjatë së cilës ka realizuar të ardhura në vlerën prej 3.985.000 lekësh. Bashkëlidhur pyetësorëve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë një vërtetim të datës 11.04.2016, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, ku deklarohet se z. Sh. M. është angazhuar si specialist pranë kësaj shoqërie nga muaji shtator 2007 deri në nëntor 2012. Pas kërkesës së Komisionit, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.08.2022, ka sqaruar se: *i ndjери, z. Sh. M., ka ofruar shërbim për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK në fushën e konsulencës, për ndërhyrjet dhe konservimin e objekteve të trashëgimisë kulturore, për periudhën kohore shtator 2007 – nëntor 2012. Për këtë periudhë kohore, z. Sh. M. është paguar në shumën totale 3.985.000 lekë, shumë të cilën e tërhiqte çdo muaj pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, pasi nuk ishte i punësuar i brendshëm i kompanisë.*
27. Komisioni, gjatë hetimit administrativ, pasi ka konstatuar se në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se prindërit dhe i vëllai, në vitin 2000 janë transferuar në Tiranë, ka pyetur subjektin lidhur me blerjen e ndonjë pasurie apartament nga prindërit në qytetin e Tiranës. Në përgjigje të pyetësorit nr. 6, subjekti ka sqaruar se *“nga komunikimi me nënën time P. M., e datëlindjes 21.03.1938 (84 vjeçe), pasi im atë Sh. M. ka vdekur në datën 21.03.2019, më ka vënë në dijeni dhe dispozicion kontratën e sipërmarrjes së datës 09.03.2004, për porositjen e një apartamenti ndodhur në rrugën ‘{\*\*\*}’, Tiranë, për të cilën është paguar me mandatarkëtimin nr. {\*\*\*}, datë 09.03.2004, shuma 61.946 euro”.*
28. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur pyetësorit nr. 6, ka paraqitur në Komision kopje të kontratës së sipërmarrjes dhe mandatit të pagesës për apartamentin e blerë nga prindërit në Tiranë. Sipas këtyre akteve, rezulton se prindërit e subjektit kanë lidhur me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në datën 09.03.2004, një kontratë sipërmarrjeje për një apartament në një godinë shumëkatëshe në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me sipërfaqe ndërtimi 112.63 m<sup>2</sup>, në katin e gjashtë. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate, porositësi, që me nënshkrimin e kontratës, ka arkëtuar pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK të gjithë shumën totale 61.946 euro. Ky fakt vërtetohet edhe nga mandatarkëtimi i datës 09.03.2004, sipas të cilit, është kryer për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, pagesa e vlerës 61.946 euro.
29. Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se veprimet e subjektit dhe prindërve të tij nuk kanë qenë veprime fiktive, por veprime juridike të kryera midis tyre, për shkak të marrëdhënieve të posaçme familjare. Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën 01.05.1993 – 01.02.2013, lidhur me mundësitë financiare të prindërve të subjektit për dhënien e shumës prej 1.700.000 lekësh. Në këtë analizë, janë përfshirë të ardhurat nga shitja e një pasurie në vitin 1996, në shumën 500.000 lekë, të ardhurat nga pensionet e përfituara ndër vite nga prindërit e subjektit, ndërsa të ardhurat e pretenduara nga punësimi i babait të subjektit pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK nuk janë përfshirë

pasi, në mungesë të provueshmërisë së plotë lidhur më këto të ardhura, nuk u krijua bindja për krijimin e tyre nga burime të ligjshme. Në analizën financiare të Komisionit, janë përfshirë edhe shpenzimet për blerjen nga nëna e subjektit, nga {\*\*\*} Berat, të një zyre në datën 05.01.1994, si dhe të një trualli në datën 13.02.1995. Në përfundim, Komisionit i ka rezultuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit kishin burime të mjaftueshme financiare për përballimin e shpenzimeve të jetesës dhe dhënien e vlerës së deklaruar prej 1.700.000 lekësh subjektit në datën 01.02.2013.

30. Nisur nga ky qëndrim i Komisionit, Komisionerja Publike në ankim, dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në parashtrime dhe në bisedimet përfundimtare, për këtë shkak ankimi, kanë kërkuar kryerjen e një analize të burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit, në funksion të verifikimit të mundësisë së tyre për të krijuar me burime të ligjshme shumën prej 1.700.000 lekësh, me të cilën kanë blerë/paguar çmimin e pjesës takuese të subjektit në apartamentin në Berat, dhe në drejtim të krijimit të besueshmërisë se ky transaksion ka ndodhur realisht. Konkretisht, Komisionerja Publike ka vlerësuar se, në kushtet kur në vitin 2004 prindërit e subjektit kanë kryer një investim për blerjen e një apartamenti në Tiranë, që është dukshëm në një vlerë më të lartë krahasuar me të ardhurat e realizuara prej tyre deri në vitin 2004, për të analizuar mbulimin me burime të ligjshme të shumës 1.700.000 lekë, dhënë subjektit të rivlerësimit, duhen llogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës së prindërve të subjektit, për periudhën mars 2004 – dhjetor 2012, si edhe investimi i kryer prej tyre në vitin 2004.
31. Trupi gjykues vëren, ashtu siç ka parashtruar edhe Komisionerja Publike në ankim, se Komisioni, megjithëse ka marrë dijeni për apartamentin e blerë nga prindërit në Tiranë, duket se ka qenë kontradiktor në standardin e aplikuar në analizën e tij për mundësinë e prindërve të subjektit për të dhënë shumën prej 1.700.000 lekësh. Siç edhe është referuar më sipër, Komisioni, në analizën financiare për periudhën 1993 – 2013, ka përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e tyre për blerjen e një zyre, në datën 05.01.1994, si dhe të një trualli, në datën 13.02.1995<sup>7</sup>, por nuk ka përfshirë shpenzimin në një vlerë të konsiderueshme për blerjen e apartamentit në Tiranë në vitin 2004, në vlerën 61.946 euro (8.000.000 lekë), megjithëse kjo blerje është realizuar në periudhën për të cilën është kryer analiza. Trupi gjykues konstaton se nuk ka asnjë argument në vendimin e Komisionit për logjikën dhe arsyet e mospërfshirjes së kësaj vlere në analizën financiare të prindërve, e cila ka passjellë për Komisionin një rezultat pozitiv për mundësinë financiare të prindërve për dhënien e shumës prej 1.700.000 lekësh.
32. Nga verifikimi i akteve në fashikujt e Komisionit, konstatohet se Komisioni, gjatë hetimit administrativ, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 3, si dhe në rezultatet e hetimit, të provojë mundësitë financiare të prindërve për dhënien e shumës prej 1.700.000 lekësh. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision disa akte për të provuar të ardhurat e prindërve nga pensioni, konkretisht, një vërtetim të datës 11.04.2016, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, ku deklarohet se babai i subjektit z. Sh. M., është angazhuar si specialist pranë kësaj shoqërie nga muaji shtator 2007 deri në nëntor 2012, shkresën e datës 12.07.2022 të kësaj shoqërie, drejtuar subjektit të rivlerësimit për të ardhurat që, sipas saj, ka përfituar babai i subjektit për periudhën e punësimit pranë saj, si dhe licencën si drejtues teknik të babait të subjektit. Subjekti i rivlerësimit, me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, ka sjellë në Komision edhe një dokument / nxjerrje llogarie për lëvizjet e llogarisë në emër të P. M., nëna e tij, në Raiffeisen Bank, për periudhën

<sup>7</sup> Sipas kontratës noteriale të datës 13.02.1995.

23.09.2005 – 30.11.2022, si dhe një librezë depozite pranë kësaj banke. Nga aktet e administruara në fashikullin e çështjes, nuk rezulton që Komisioni të ketë kryer hetime të mëtejshme për depozita apo llogari bankare të prindërve të tij, apo për investime të realizuara prej tyre, me përjashtim të apartamentit në Tiranë.

33. Sa i përket pretendimit të Komisioneres Publike lidhur me analizën financiare për mundësinë e prindërve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e gjeti të drejtë vlerësimin e Komisioneres Publike, që kjo analizë financiare duhet të kryhet për periudhën mars 2004 – dhjetor 2012, që i korrespondon periudhës nga momenti pas blerjes së apartamentit në vitin 2004, deri në momentin e dhënies së shumës 1.700.000 lekë. Trupi gjykues vlerësoi se një qasje e tillë synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe objektive mbi mundësinë reale të prindërve për të gjeneruar dhe dhënë këtë shumë në favor të subjektit të rivlerësimit, e të përdorur prej tij, siç pretendohet, si burim për pasurinë “apartament”. Analizimi i mundësisë financiare të prindërve, i shtrirë në kohë prej vitit 1993, do të ishte jo objektiv, në kushtet kur prindërit e subjektit të rivlerësimit, edhe në vitin 2004 kanë blerë pasurinë “apartament” në Tiranë, në një vlerë më të lartë krahasuar me të ardhurat e realizuara prej tyre deri në vitin 2004 (pra, në kushtet e një pamundësie financiare, në vlerë të konsiderueshme prej -7.317.624 lekësh<sup>8</sup>), por edhe në konsideratë të faktit se, në kuadër të këtij procesi, duhet të verifikohet mundësia financiare e prindërve për t’i dhënë subjektit shumën prej 1.700.000 lekësh pas blerjes së apartamentit në Tiranë, dhe jo mundësia financiare e tyre për ta blerë këtë apartament në vitin 2004, pasuri kjo, e cila është jashtë objektit të kontrollit të procesit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se përllogaritja e mundësisë financiare të prindërve për të dhënë shumën prej 1.700.000 lekësh, prej vitit 2004 deri në dhjetor të vitit 2012, mban në konsideratë edhe se, nga tërësia e fakteve të provuara gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit të ketë kontribuar apo të ketë pasur ndonjë tagër pronësie, të drejtë reale, apo edhe marrëdhënie me këtë pasuri.
34. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, ashtu si në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, në lidhje më të ardhurat e prindërve, ka pretenduar përfshirjen në analizën financiare edhe të të ardhurave të tjera të krijuara nga babai i tij, përveç pensionit të pleqërisë. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, për periudhën shtator 2007 – nëntor 2012, babai i tij ka realizuar të ardhura nga punësimi si specialist/drejtues teknik i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në vlerën 3.985.000 lekë, si dhe të ardhura si specialist i punëve publike pranë Zyrës {\*\*\*} Berat, për periudhën 1998 – 1999.
35. Për të provuar deklaratimet lidhur me mundësinë financiare të prindërve për krijimin e shumës prej 1.700.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, shkresën e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nr. {\*\*\*} prot., datë 19.08.2022, në të cilën informohet se, për periudhën kohore shtator 2007 – nëntor 2012, z. Sh. M. është paguar në shumën totale 3.985.000 lekë, shumë të cilën e tërhiqte çdo muaj pranë shoqërisë, pasi nuk ishte i punësuar i brendshëm i saj. Në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka sjellë një vërtetim të datës 30.11.2022, lëshuar po nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, ku deklorohet se z. Sh. M. ka qenë i pajisur me licencë profesionale dhe ka ofruar shërbim për shoqërinë. Për këtë periudhë

---

<sup>8</sup> Kjo mungesë burimesh financiare të ligjshme e prindërve të subjektit rezulton nëse në analizën e kryer nga Komisioni, do të përfshihej si shpenzim çmimi prej 61.946 eurosh (ekuivalent me rreth 8.000.000 lekë) i blerjes së apartamentit në Tiranë.

*kohore, ai ka qenë pensionist dhe përfitonte pension nga kontributet e paguara gjatë periudhës së punës. Për këtë arsye, nuk mund të pasqyrohej në listëpagesa, për efekt të sigurimeve shoqërore. Meqenëse nuk mund të deklarohej në listëpagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, për z. Sh. M. është mbajtur vetëm tatimi mbi të ardhurat personale. Tatimi 10% mbi të ardhurat personale, i mbajtur në burim për këtë person, është transferuar në buxhetin e shtetit nëpërmjet deklaratës përmbledhëse të tatimit të mbajtur në burim.*

36. Komisioni, me qëllim verifikimin e të ardhurave të babait të subjektit të rivlerësimit, i është drejtuar me shkresë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (në vijim DPT), e cila, në përgjigjen e saj nr. {\*\*\*} prot., datë 02.08.2022, ka informuar se *në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore nga ana e kompanisë “{\*\*\*}” për shtetasin Sh. M. si punëmarrës, DPT ju bën me dije se organi tatimor vepron si agjent i mbajtjes së tatimit për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe nuk merret me administrimin e tyre. Theksojmë se, nga sistemi informativ i DPT-së, për periudhën para datës 01.01.2012, nuk mund të marrim ndonjë informacion në lidhje me listëpagesat e ndonjë subjekti privat apo shtetëror, por një informacion të tillë mund ta gjeni pranë ISSH-së.*
37. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar të ardhurat e pretenduara në periudhën 1998 – 1999, nga punësimi i babait si specialist i punëve publike pranë Zyrës {\*\*\*} Berat, ka sjellë në Komision, bashkë me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, shkresën nr. {\*\*\*}, datë 01.12.2022, të Drejtorisë Rajonale {\*\*\*} Berat, sipas së cilës, nga shqyrtimi i dokumentacionit fizik dhe manual, z. Sh. M. figuron vetëm të ketë firmosur si specialist në situacionet e disa punëve publike për vitet 1998 – 1999. Në përfundim, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë vlerën e të ardhurave të pretenduara, dhe as pagimin e detyrimeve përkatëse në buxhetin e shtetit mbi këto të ardhura.
38. Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, Komisioni ka çmuar se sqarimet lidhur me mospagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga punësimi kanë mbetur vetëm në kuadrin deklarativ, pasi nuk janë shoqëruar me ndonjë dokumentacion shkresor provues lëshuar nga institucionet publike përgjegjëse. Në mungesë të provueshmërisë së plotë lidhur me të ardhurat e ligjshme, të pretenduara të përfituara nga babai i subjektit, Komisioni ka konkluduar se këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare, pasi nuk u krijua bindja lidhur me mundësitë e prindërve për krijimin e këtyre vlerave financiare nga burime të ligjshme.
39. Nga të dhënat e shkresës së Drejtorisë Rajonale {\*\*\*} Berat, nuk rezulton asnjë indicie që të provojë një marrëdhënie formale punësimi të babait të subjektit të rivlerësimit si specialist i punëve publike pranë Zyrës {\*\*\*} Berat, apo realizimin e të ardhurave të pretenduara për periudhën 1998 – 1998. Edhe vetë subjekti i rivlerësimit, si gjatë zhvillimit të procesit në Komision, ashtu dhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk ka pretenduar një vlerë konkrete për të ardhurat nga ky punësim i të atit për këtë periudhë. Në këto kushte, trupi gjykues ndan të njëjtin qëndrim me Komisionin, se subjekti nuk arriti të provojë vlerën e të ardhurave të pretenduara, dhe as pagimin e detyrimeve përkatëse tatimore mbi këto të ardhura.
40. Për sa u përket të ardhurave të pretenduara nga punësimi i babait në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion justifikues ligjor burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, as në formën e një marrëdhënieje

punësimi, dhe as në formën e një marrëdhënieje kontraktuale të një lloji tjetër. Subjekti i rivlerësimit, jo vetëm nuk ka arritur të provojë vlerën e të ardhurave të pretenduara prej tij për punësimin e babait, pasi informacioni i dhënë nuk është i plotë, por nuk ka provuar as ligjshmërinë e tyre në drejtim të pagesës së detyrimeve tatimore. Mungesa e dokumentimit të marrëdhënies së punësimit apo të konsulencës është një fakt determinues për rrëzimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se, për pagesat e pretenduara, që janë kryer nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK kundrejt tij, detyrimi për deklarimin, mbajtjen dhe pagimin e tatimit përkatës i përkiste shoqërisë. Trupi gjykues vlerëson se, sipas legjislacionit tatimor, nuk mund të paguhen detyrime tatimore për një individ me të cilin shoqëria tregtare nuk ka formalizuar asnjë lloj marrëdhënieje, nga ato që përfshihen në objektin e rregullimit të legjislacionit për tatimin mbi të ardhurat. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë gjykimit në Kolegj, nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues financiar/ligjor të ardhurat e përfituara nga punësimi i babait të tij, Sh. M., pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe, për pasojë, këto të ardhura të pretenduara nuk mund të përfshihen në analizën financiare të prindërve.

41. Trupi gjykues vlerëson të bazuar edhe konstatimin e Komisioneres Publike, të konfirmuar dhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, se si pagesë e kryer për apartamentin në vitin 2013 duhet të merret vlera 1.750.000 lekë, dhe jo vlera prej 1.650.000 lekësh që ka konsideruar Komisioni në analizën financiare për mundësinë e pagesës së kështit të parë të apartamentit. Komisioni, duke pranuar deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, se është paguar vlera 100.000 lekë në vitin 2009, ka konsideruar se, në vitin 2013, është paguar pjesa tjetër e kështit, dhe ka analizuar mundësinë e subjektit për të paguar shumën e mbetur prej 1.650.000 lekësh në vitin 2013. Nga verifikimi i akteve të administruara gjatë hetimit në Komision, trupi gjykues vëren se, sipas deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 15.04.2013, midis shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe subjektit, konfirmohet se kësti i parë është likuiduar *cash*, në dorë, në shumën 1.750.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë në Komision, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, vërtetimin nr. {\*\*\*} prot., datë 15.06.2022, të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, sipas të cilit, pagesat për blerjen e apartamentit janë kryer sipas përcaktimeve në kontratën e shitjes me kusht kreditimi. Bashkëlidhur vërtetimit, është edhe mandati i arkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 02.03.2013, lëshuar nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, sipas të cilit, është arkëtuar nga subjekti i rivlerësimit vlera 1.750.000 lekë, likuidim për blerje apartamenti. Trupi gjykues, në konsideratë të akteve të mësipërme, vlerësoi se ato kundërshtojnë deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, në të cilën ai ka deklaruar një pagesë në vlerën prej 100.000 lekësh, kryerjen e së cilës ai nuk ka mundur ta provojë, dhe që duket se është paguar realisht më vonë, si pjesë e kështit të parë prej 1.750.000 lekësh.
42. Në vijim të konkluzioneve të mësipërme, në kushtet kur investimi i kryer nga prindërit për blerjen e apartamentit në Tiranë, rezulton nga aktet se është finalizuar në datën 09.03.2004, Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, bazuar në të dhënat e analizës financiare të Komisionit, ka kryer një kontroll lidhur me mundësinë e prindërve për dhënie të shumës prej 1.700.000 lekësh për periudhën nga mars 2004, pas blerjes së apartamentit në Tiranë, deri në dhjetor 2012. Kontrolli i analizës për mundësinë financiare të prindërve u krye në funksion të krijimit të bindjes/besueshmërisë, si një element i rëndësishëm për të konkluduar lidhur me ekzistencën e transaksionit të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, për premtimin e shitjes së pjesës takuese të tij në pasurinë në bashkëpronësi në Berat. Nga kjo analizë, në të cilën u përfshinë vetëm të ardhurat

e përfituara nga pensionet, prindërit e subjektit të rivlerësimit rezultojnë me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 889.666 lekë, për krijimin e shumës 1.700.000 lekë.

43. Në përgjigje të pretendimit të Komisioneres Publike, që pagesa prej 100.000 lekësh e deklaruar në deklaratën periodike të interesave pasurorë të vitit 2009 duhet të përfshihet në analizën financiare për pagesat e kryera për apartamentin, konstatohet si vijon. Nga aktet e administruara në fashikujt e Komisionit, rezulton se, më datë 03.05.2013, nga banka BKT është lëvruar kredia në vlerën 2.900.000 lekë, nga të cilat 2.860.000 lekë janë transferuar në favor të shoqërisë ndërtuese si pagesë për blerjen e apartamentit. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*, si dhe gjatë procesit në Komision, se pjesa tjetër në vlerën prej 1.700.000 lekësh është siguruar nga prindërit e tij për likuidimin e kështit të parë, sipas marrëveshjes për shitjen e pjesës së tij takuese të apartamentit në Berat. Duke marrë në konsideratë që vlera totale e apartamentit është 4.650.000 lekë, diferenca ndërmjet kësaj shume dhe totalit të dy pagesave të mësipërme rezulton (-) 90.000 lekë. Kjo diferencë, në dukje, mund të përkojë me shumën prej 100.000 lekësh të paguar në vitin 2009, e cila është deklaruar si pagesë paraprake dhe konsideruar pjesë përbërëse e çmimit të përgjithshëm të apartamentit. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike vjetore, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjë vit kursime *cash*, ndërkohë që, në nenin 4, shkronja “d”, të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, është përcaktuar qartë detyrimi i zyrtarit deklarues për deklarimin e shtesave apo pakësimeve të likuiditeteve *cash*. Si rrjedhojë, trupi gjykues analizoi nëse kjo shumë mund të jetë krijuar me kursimet familjare të periudhës 01.01.2013 – 04.02.2013 (data e nënshkrimit të kontratës së shitjes së apartamenti objekt analize), prej së cilës rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 95.868 lekë për krijimin e shumës 90.000 lekë, më datë 04.02.2013, kur është shlyer kështi i parë. Për rrjedhojë, sipas kësaj analize, më së paku, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e pagesës së kështit të parë të apartamentit, në vlerën (-) 1.660.000 lekë.

44. Komisionerja Publike, në ankimin drejtuar Kolegjit, lidhur me pasurinë “apartament” në Fier, thekson edhe disa rrethana të tjera faktike, të dala nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, të cilat sillen në vëmendje të Kolegjit për një vlerësim të plotë të situatës faktike lidhur me shumën prej 1.700.000 lekësh, dhënë subjektit nga prindërit e tij, pra, për vërtetësinë e deklarimeve të tij dhe ekzistencën reale të këtij transaksioni. Rrethanat e referuara në ankim nga Komisionerja Publike<sup>9</sup> janë si vijon.

44.1. Referuar shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 18.7.2022, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, subjekti Genci Mane rezulton bashkëpronar në pasuritë me nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}, së bashku me prindërit dhe vëllanë. Këto pasuri duket të jenë rivlerësuar në vitin 2017 dhe vlera e tyre pas rivlerësimit është 2.614.791 lekë, nga ku pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit llogaritet në vlerën 653.697 lekë. Pra, subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë marrë nga prindërit e tij një vlerë disa herë më të lartë se vlera e tregut për pjesën e tij takuese, por pa vërtetuar mënyrën e kalimit të kësaj shume.

44.2. Sikurse është konstatuar edhe nga Komisioni, apartamenti me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>, i blerë nga subjekti në vitin 2013, sipas Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”), llogaritet në vlerën

<sup>9</sup> Paragrafi 17.10.5 i ankimit, me nënparagrafët përkatës 17.10.5.1 - 17.10.5.5.

8.534.610 lekë, ndërsa subjekti e ka blerë këtë pasuri në vlerën 4.650.000 lekë, pra, më pak se vlera e tregut.

44.3. Gjithashtu, konstatohet se Furnizuesi i Shërbimit Universal, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.6.2022, ka konfirmuar se: (i) me gjeneralitetet Genci Sh. Mane, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. {\*\*\*}, në instancën Fier, dhe (ii) me gjeneralitetet Genci Mane (pa atësi), identifikohet një abonent me kontratë të furnizimit nr. {\*\*\*}, në instancën Fier. Rezulton se të dyja këto kontrata janë lidhur në vitin 2011, përkatësisht në kabinën “{\*\*\*\*} {\*\*\*\*}” dhe “{\*\*\*\*}”. Nga aktet në dosje, konstatohet se nuk është hetuar/kërkuar informacion në lidhje me kontrata të furnizimit midis subjektit dhe personave të lidhur, me Shoqërinë e Ujësjetës-Kanalizime ShA Fier.

44.4. Lidhur me kredinë e miratuar nga BKT, Dega Fier, për subjektin e rivlerësimit, arsyetimi i Komisionit është përqendruar në referencë të vendimit nr. 600, datë 01.09.2007, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, ndërkohë që miratimi i kredisë është në kuadër të projektit të pastrehëve të Bashkisë Fier.

45. Lidhur me konstatimin e Komisioneres Publike, se subjekti i rivlerësimit ka marrë nga prindërit e tij një vlerë disa herë më të lartë se vlera e tregut për pjesën e tij takuese, trupi gjykues vëren se, edhe Komisioni, pas një vlerësimi lidhur me vlerën e tregut për apartamentin në qytetin e Beratit, ka konkluduar në gjetjen e pasqyruar në rezultatet paraprake të hetimit, se duket se subjekti i rivlerësimit u ka shitur prindërve pjesën e tij takuese të pasurisë “banesë dhe truall”, me një vlerë më të lartë sesa vlera e tregut, në vitin 2013.

46. Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlera e shitjes së pjesës takuese ka qenë një marrëdhënie juridiko-civile ndërmjet tij dhe prindërve, duke marrë në konsideratë lidhjen familjare, faktin që kjo banesë ndodhet në një qytet muze, të mbrojtur edhe nga UNESCO dhe se, gjatë kohës që ka jetuar në këtë banesë, ai ka kryer edhe investime, të cilat i ka deklaruar edhe në Komision.

47. Nga kontrolli i kryer në Kolegj, për vlerësimin e kësaj rrethane të evidentuar në ankim nga Komisionerja Publike, rezulton se vlera e shitjes së pjesës takuese të subjektit të prindërit në vitin 2013, është pothuajse dy herë më e lartë se vlera e saj në tregun e lirë për këtë vit. Bazuar në çmimin e referencës të përcaktuar nga EKB-ja për qytetin e Beratit, në vitin 2013, vlera e pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit do të ishte 629.681 lekë<sup>10</sup>. Vlera prej 1.700.000 lekësh e përfituar nga prindërit, rezulton të jetë më e lartë, edhe sipas rivlerësimit të pasurisë “apartament”, të kryer në vitin 2017. Bazuar në shkresën “kthim përgjigje” të ASHK-së Berat, nr. {\*\*\*} prot., datë 09.10.2017, rezulton se pasuria “apartament”, në bashkëpronësi të subjektit, së bashku me

---

<sup>10</sup> Sipas udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, të Entit Kombëtar të Banesave, vlera mesatare e shitblerjeve të apartamenteve në tregun e lirë deri në muajin maj 2013, në Berat, ishte 39.350 lekë/m<sup>2</sup>. Sipas këtij udhëzimi, vlera e apartamentit do të ishte 82 m<sup>2</sup> x 39.350 lekë/m<sup>2</sup> = 3.226.700 lekë. Bazuar në vlerën e referuar në VKM-në nr. 514, datë 30.07.2014, “Për miratimin e vlerës së pronës për çdo rreth të Republikës së Shqipërisë”, vlera e tokës me sipërfaqe 57 m,<sup>2</sup> për vitin 2013, do të ishte 57 m<sup>2</sup> x 4.562 lekë/m<sup>2</sup> = 260.034 lekë. Në total, për të dy pasuritë vlera është 2.518.724 lekë, pas aplikimit të koeficientit 70%, sipas metodologjisë së ndjekur nga ZVRPP-ja për vlerësimin e pasurisë “apartament” dhe pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit llogaritet të jetë 2.518.724 lekë \* ¼ = 629.681 lekë.

prindërit dhe vëllanë e tij, është rivlerësuar në datën 09.02.2017, në vlerën 2.376.360 lekë, ndërsa “trualli” është rivlerësuar në datën 18.04.2017, për një vlerë prej 238.431 lekësh, në total, të dyja pasuritë janë rivlerësuar në vlerën 2.614.791 lekë. Pjesa takuese e subjektit prej ¼, në rivlerësimin e këtyre pasurive, përlllogaritet të jetë në vlerën 653.698 lekë, një vlerë kjo dukshëm më e ulët se vlera 1.700.000 lekë që ai pretendon të ketë përfituar nga prindërit në vitin 2013.

48. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se qëndron konstatimi i Komisioneres Publike se subjekti ka përfituar një vlerë më të lartë se vlera e tregut për pjesën e tij takuese, fakt ky që është mbajtur në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin për shkakun e ankimit që i përket mundësisë financiare të prindërve për t’i dhënë subjektit vlerën prej 1.700.000 lekësh, dhe provueshmërinë e përfitimit të kësaj shume nga subjekti i rivlerësimit.
49. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se deklarata noteriale e vitit 2013 e prindërve nuk ka sjellë asnjë pasojë në drejtim të zhveshjes/çregjistrimit si pronar të subjektit të rivlerësimit deri në datën 28.02.2024, kur ai ka dhuruar pjesën e tij. Rezulton nga aktet se, edhe kërkesa për çeljen e trashëgimisë për pasuritë e babait të ndjerë (përfshirë edhe pasurinë në bashkëpronësi në Berat), përveçse është bërë në datën 30.11.2022, rreth tri vite pasi ai kishte ndërruar jetë, është bërë vetëm pas njohjes nga subjekti me rezultatet paraprake të hetimit, dhe kalimit të barrës së provës nga Komisioni për mundësinë e krijimit të shumës prej 1.700.000 lekësh nga prindërit e tij. Për më tepër, trupi gjykues çmon të theksojë se, pas çeljes së kësaj trashëgimie, edhe dhurimi nga subjekti i pjesës takuese për pasurinë në bashkëpronësi në Berat, me kontratën e dhurimit të datës 28.02.2024, daton pas ushtrimit të ankimit nga Komisionerja Publike ndaj vendimit të Komisionit, më datë 31.01.2023. Këto konstatime të trupit gjykues bazohen në aktet si vijojnë. Sipas deklaratës noteriale të prindërve për shitjen e pjesës takuese, nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 01.02.2013, të paraqitur në Komision bashkë me pyetësorin shtesë të datës 08.06.2022, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se premtan t’i shesë pjesën e tij takuese prej ¼ të apartamentit në bashkëpronësi, prindërve të tij, dhe se ka marrë në dorëzim vlerën 1.700.000 lekë nga prindërit në ditën e lidhjes së kësaj marrëveshjeje. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, bashkë me parashtrimet para seancës gjyqësore publike të datës 24.06.2025, ka sjellë për t’u administruar si provë, kontratën noteriale të dhurimit, me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.02.2024, sipas së cilës, subjekti i rivlerësimit i dhuron nënës së tij pjesën e tij takuese në banesën e përbashkët që ka pasur me prindërit dhe të pjesës takuese që ka përfituar nga trashëgimia ligjore pas vdekjes së babait. Të gjithë këto akte dhe rrethana faktike, në vlerësimin e trupit gjykues, vënë në dyshim shitjen reale të pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit në vitin 2013, për sa kohë që deklarata noteriale e vitit 2013 nuk ka sjellë pasojën e zhveshjes së subjektit nga tagrat e pronarit dhe çregjistrimin e tij si pronar në aktet e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për më tepër, duket se deklarata noteriale e vitit 2013 është përpiluar nga prindërit, me qëllim plotësimin nga subjekti të kushteve të përfitimit të kredisë së butë për banesa në tregun e lirë, nga programet sociale të strehimit, siç është analizuar në vijim në këtë vendim. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues krijoi bindjen se shuma prej 1.700.000 lekësh nuk është përfituar prej subjektit të rivlerësimit, në konsideratë edhe të konkluzionit të mësipërm lidhur me pamundësinë financiare të prindërve për t’i dhënë subjektit këtë shumë.
50. Për sa i përket konstatimit të Komisioneres Publike, se apartamenti me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>, i blerë nga subjekti në vitin 2013, sipas EKB-së, llogaritet në vlerën 8.534.610 lekë, ndërsa subjekti i

rivlerësimin e ka deklaruar në vlerën 4.650.000 lekë, pra, më pak se vlera e tregut, nga aktet në fashikujt e Komisionit rezultojnë se:

**50.1.** Komisioni ka hetuar për çmimin e blerjes së kësaj pasurie në raport me çmimet e përcaktuara për ndërtimet në qytetin e Fierit. Bazuar në Udhëzimin nr. 1, datë 20.08.2008, të Këshillit të Ministrave, sipas Komisionit, ka rezultuar se vlera e tregut të lirë të apartamenteve në qytetin e Fierit është 55.062 lekë/m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e ndërtimit të apartamentit të blerë nga subjekti i rivlerësimit është 140 m<sup>2</sup> + 15 m<sup>2</sup> (sipërfaqe të përbashkëta) dhe kostoja llogaritet në vlerën prej 8.534.610 lekësh (140 + 15 x 55.062 lekë), pra, subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë pasuri në vlerën 4.650.000 lekë, pra, shumë më pak se vlera e tregut.

**50.2.** Bazuar në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.06.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës, nuk ka hetuar asnjë procedim penal ndaj ortakut të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, z. Y. I., dhe as ndaj administratorit, z. A. Ç.

**50.3.** Sipas shkresës së ASHK-së Fier, nr. {\*\*\*} prot., datë 19.08.2022, vlerat për tipologjinë e përafërt të apartamentit dhe sipërfaqes ndërtimore për vitin 2012 variojnë nga 33.000 lekë/m<sup>2</sup> në 67.000 lekë/m<sup>2</sup>.

**50.4.** Bashkëlidhur rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një raport vlerësimi të datës 30.11.2022, të ekspertit të licencuar, inxhinierit S. S., sipas të cilit, për shkak të vendosjes së apartamentit midis dy seksioneve, dhe për shkak të dëmtimeve, ai nuk plotëson kushtet teknike për të qenë një objekt funksional normal. Për rrjedhojë, për shkak të problematikave, çmimi për m<sup>2</sup> është më i ulët se çmimi i tregut apo ai i përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave.

**50.5.** Gjithashtu, me rezultatet e hetimit, subjekti ka sjellë edhe një vërtetim nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, të datës 01.12.2022, sipas të cilit, për shkak të ndërtimit të pallatit në dy seksione të ndara, në hapësirën e fugës sizmike, janë shfaqur probleme me çarjen e mureve dhe dyshemeve dhe, për këtë arsye, nga 9 (nëntë) apartamente që ndodhen në këtë pozicion janë shitur vetëm 4 (katër) prej tyre.

**51.** Komisioni, pavarësisht konstatimit në rezultatet e hetimit, se subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë apartament më pak se vlera e tregut, ka arritur në përfundimin se nuk ekziston ndonjë trajtim preferencial ndaj subjektit apo konflikt interesi me palën shitëse për blerjen e pasurisë “apartament” në qytetin e Fierit. Komisioni ka vlerësuar se vullneti i palëve mbi marrëdhënien kontraktore për shitblerjen e pasurisë është shprehur në formën e duhur shkresore (me anë të kontratës së shitjes së sendit në të ardhmen dhe kontratës së shitblerjes). Palët, në të dyja këto kontrata, kanë caktuar çmimin e njëjtë të shitjes së pasurisë “apartament”, me vullnetin e lirë të tyre. Sipas Komisionit, subjekti ka qenë koherent në deklarin e kësaj pasurie dhe burimit të krijimit, që nga deklarata periodike, deklarata *vetting*, dhe në përgjigje të pyetësorit. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur asnjë çështje penale me palën shitëse të pasurisë (si për shoqërinë, dhe për ortakët e saj). Gjithashtu, në këtë godinë, ku ndodhet pasuria “apartament”, e blerë nga subjekti, ekzistojnë edhe apartamente të tjera, të blera nga individë të ndryshëm, me vlerë më të vogël se vlera e blerjes nga ana e subjektit.

52. Në Komision, ashtu si dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se çmimi i blerjes së banesës ka qenë sipas tregut, dhe në të njëjtën mënyrë si edhe për blerës të tjerë nga kjo shoqëri të apartamenteve në këtë pallat. Çmimi i blerjes është përcaktuar që në kontratën e premtim-shitjes të vitit 2009, ku është parashikuar blerja nëpërmjet kreditimit. Komisionerja Publike ka llogaritur një vlerë 8.534.610 lekë për apartamentin, por nuk ka cituar se cilit udhëzim të EKB-së i është referuar. Për vitin 2009, ka qenë në fuqi Udhëzimi nr. 1, datë 20.08.2008 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008”, sipas të cilit, kostoja e ndërtimit për sipërfaqe ndërtimore është 27.710 lekë/m<sup>2</sup>. Duke iu referuar këtij udhëzimi, vlera e apartamentit nuk është 8.534.610 lekë, siç pretendon Komisionerja Publike, por 4.295.050 lekë. Ashtu siç dhe është provuar nga vetë Komisioni, rezulton se marrëdhënia me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, pronarin apo administratorin e saj, ka qenë vetëm marrëdhënie e natyrës juridiko-civile. Në asnjë rast, nuk u provua nga Komisioni që ai, si prokuror, të ketë pasur çështje me shoqërinë, pronarin apo administratorin. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje se kjo banesë ndodhet në hapësirën e fugës sizmike ku vendoset pallati, dhe kjo ka sjellë në mënyrë permanente dëmtime, jo vetëm të banesës së tij, por të të gjithë seksionit. Lidhur me këtë pretendim, subjekti ka paraqitur në Komision edhe një ekspertim teknik vlerësues, i cili ka analizuar shkaqet teknike dhe ka bërë edhe vlerësimin, duke u mbështetur në këta faktorë risku.
53. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting* dhe në deklaratat periodike vjetore të viteve 2009 dhe 2013, ka deklaruar se vlera e blerjes së apartamentit ka qenë 4.650.000 lekë. Referuar të dhënave të tregut të lirë të shitjes së apartamenteve, sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 1, datë 20.08.2008, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, në qytetin e Fierit, vlera mesatare në tregun e lirë, për apartamentin objekt shqyrtimi, ka qenë 55.062 lekë/m<sup>2</sup>. Subjekti i rivlerësimit, në përlllogaritjen e vlerës së apartamentit, në mënyrë të gabuar i referohet kostos mesatare të ndërtimit për m<sup>2</sup> që, për qytetin e Fierit, sipas udhëzimit të sipërpërmendur, ka qenë 27.710 lekë, ndërkohë që apartamenti është blerë në tregun e lirë dhe, për rrjedhojë, kostoja e tij për m<sup>2</sup> duhet të llogaritet sipas të dhënave të tregut të lirë të apartamenteve. Sipërfaqja e ndërtimit të blerë nga subjekti i rivlerësimit është 155 m<sup>2</sup> (140 m<sup>2</sup> apartamenti + 15 m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët) dhe vlera e apartamentit përlllogaritet të jetë 8.534.610 lekë (140 m<sup>2</sup> + 15 m<sup>2</sup> x 55.062 lekë/m<sup>2</sup>), e njëjta vlerë që ka konkluduar Komisioni dhe Komisionerja Publike. Pra, rezulton se vlera e blerjes së apartamentit në lagjen “{\*\*\*}” në Fier, është nën vlerën e çmimeve të tregut të lirë, të referuara nga EKB-ja për qytetin e Fierit në vitin 2009.
54. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjatë gjykimit në Kolegj disa kontrata shitblerjesh të apartamenteve në objektin ku gjendet edhe apartamenti i tij, kontrata të cilat konstatohet se janë sjellë në Komision edhe nga AShK-ja, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.08.2022. Nga verifikimi i të dhënave të këtyre kontratave, trupi gjykues konstaton se çmimet e apartamenteve të tjera, të shitura po nga shoqëria ndërtuese “{\*\*\*}” ShPK, individëve të ndryshëm për vitin 2012, variojnë nga 33.000 lekë/m<sup>2</sup> në 67.000 lekë/m<sup>2</sup>, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit e ka blerë apartamentin me një çmim prej 30.000 lekësh/m<sup>2</sup>. Trupit gjykues, referuar kontratave të sjella nga subjekti i rivlerësimit, i rezulton se çmimi për m<sup>2</sup>, i parashikuar në kontratën për apartamentin e tij, është më i ulët se ai i referuar në këto kontrata, për rrjedhojë, ato nuk përmbysin pretendimin e tij lidhur me çmimin me të cilin ai e kishte blerë këtë apartament, duke provuar, madje edhe një çmim mesatar më të lartë se ai i përfituar prej tij.

55. Gjithashtu, trupi gjykues, në drejtim të krijimit të besueshmërisë për çmimin e blerjes së apartamentit, vlerëson edhe faktin që, nga momenti i fillimit të banimit në apartament, sipas deklarimeve të tij<sup>11</sup>, në vitin 2010, dhe deri në nënshkrimin e kontratës me kusht kreditimi më datë 04.02.2013, subjekti i rivlerësimit e kishte marrë apartamentin në posedim nga shoqëria e ndërtimit “{\*\*\*}” ShPK<sup>12</sup>, ndonëse kishte paguar një vlerë të papërfillshme prej 100.000 lekësh të çmimit të apartamentit.
56. Bazuar në vlerësimet e konkluzionet si më sipër referuar<sup>13</sup>, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e pagesës së këstit të parë të apartamentit, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe nuk arrin nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë<sup>14</sup>.
57. Lidhur me konstatimin e Komisioneres Publike, të konfirmuar edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, *se arsyetimi i Komisionit për kredinë e miratuar nga BKT, dega Fier, është përqendruar në referencë të vendimit nr. 600, datë 01.09.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, ndërkohë që miratimi i kredisë është bërë në kuadër të projektit të të pastrehëve të Bashkisë Fier, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.*
- 57.1. Nga aktet e administruara në fashikujt e Komisionit, rezulton se kredia në vlerën 2.900.000 lekë, lëvruar nga banka BKT më datë 03.05.2013, është një kredi që i është dhënë subjektit të rivlerësimit, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. {\*\*\*}, datë 30.10.2012, bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, nenit 5 dhe 25, dhe VKM-së nr. 53, datë 28.01.2005, “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfituar strehim nga programet e banesave sociale”. Vetë subjekti i rivlerësimit, në lidhje me përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, në përgjigje të pyetësorëve, si dhe në prapësimet ndaj rezultateve të hetimit të Komisionit, ka sqaruar se kjo kredi i është dhënë nga Bashkia Fier. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 6, ka paraqitur në Komision kërkesën e datës 16.10.2009, drejtuar Bashkisë Fier, vendimin nr. {\*\*\*}, datë 30.10.2012, të Këshillit Bashkiak Fier, së bashku me listën emërore të familjeve të pastreha, si dhe vërtetimin nr. {\*\*\*}, datë 22.09.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, sipas të cilit, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur ndonjë çështje penale me palë Bashkinë Fier.
- 57.2. Komisioni, në rezultatet paraprake të hetimit, ka konstatuar se, bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, duket se subjekti i rivlerësimit nuk plotësonte kriteret ligjore për t’u kualifikuar si përfitues i kësaj kredie.

<sup>11</sup> Deklarimi i adresës në deklaratat periodike vjetore të interesave pasurorë (DPV) 2009, 2010, e në vijim, si dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin standard.

<sup>12</sup> Nga informacioni nga burime të hapura, rezulton se ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, më datë 31 korrik 2021, nga Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, është vendosur masa e sekuestros, bazuar në ligjin nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

<sup>13</sup> Paragrafët 39, 40, 41, 48, 53, të vendimit.

<sup>14</sup> Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe informacionet nga organet ligjzbatuese.

Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk plotësonte kriteret ligjore lidhur me kufirin e të ardhurave, pasi duket se dispononte të ardhura familjare më të larta se parashikimi ligjor, si dhe dispononte banesë tjetër në qytetin e Beratit, si bashkëpronar i një pasurie të paluajtshme. Por, trupi gjykues vëren se, në vendim, Komisioni, pavarësisht konstatimit të mësipërm në rezultatet e hetimit, ka bërë një interpretim lidhur me kriteret për përfitimin e kredisë, duke iu referuar në mënyrë të gabuar si bazë ligjore, vendimit nr. 600, datë 01.09.2007, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë” (në vijim VKM-ja nr. 600, datë 01.09.2007), një interpretim ky që nuk bazohet në rrethanat faktike dhe aktet e cituara më sipër. VKM-ja nr. 600, datë 01.09.2007, parashikon kriteret për përftimin e kredive me kushte lehtësuese për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, që trajtohen me strehim, ndërsa ligji 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, mbi bazën e të cilit ka përfituar kredinë subjekti i rivlerësimit, ka pasur si objekt krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballeshëm, të familjeve me të ardhura të pakta, që kanë nevojë për strehim dhe për ndihmën e shtetit.

58. Subjekti i rivlerësimit, si në procesin e zhvilluar në Komision, ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, ka mbajtur qëndrimin se *familja ime në Fier ishte e pastrehë dhe kemi aplikuar pranë bashkisë për trajtimin si të pastrehë. Këshilli Bashkiak, pasi ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin, i ka gjetur ato në pajtim me ligjin dhe ka miratuar kërkesën, duke më përfshirë në listat e të pastrehëve. Nëse kërkesa ime nuk do të plotësonte kriteret, pa diskutim, Këshilli Bashkiak, si organi kolegjial kompetent, do ta kishte refuzuar atë. Trajtimi me kredi të buta i zyrtarëve që kryenin funksione shtetërore ka qenë një qasje jo vetëm e Bashkisë Fier, por e të gjithë pushtetit vendor.*
59. Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se kredia për strehim, për banesë me kosto të ulët, në vlerën 2.900.000 lekë, me normë interesi 3% në muaj, i është akorduar subjektit dhe familjes së tij (me katër anëtarë), në vijim të miratimit të listës së përfituesve, miratuar nga Këshilli Bashkiak Fier, në tetor 2012. Nëpërmjet kësaj kredie, të disbursuar në datën 25.04.2013, sipas kontratës me Bankën Kombëtare Tregtare, subjekti i rivlerësimit ka paguar këstin e dytë të pasurisë “apartament”, objekt kontrolli.
60. Kredia e dhënë, sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 30.10.2012, të Këshillit Bashkiak Fier, është përfituar në bazë të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”. Sipas këtij ligji, dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Financave, dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, nr. 6257/2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti” (në vijim “Udhëzimi nr. 6257/2008”), programet sociale të strehimit kanë për fokus familjet apo individët, të cilët, për shkaqe ekonomike e sociale, nuk mund të përballojnë çmimet e banesave në treg apo atë të kredive hipotekore. Sipas nenit 4 të këtij ligji, *përfitojnë strehim individët që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme: a) nuk kanë në pronësi një banesë; b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi; c) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore.* 2. *Përfshihen në njëërën nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni, vetëm ato familje, që kanë të ardhura të pamjaftueshme.* Ndërsa sipas pikës 2, të nenit 19 të ligjit nr.

9232/2004, lexuar në harmoni me nenin 25 të të njëjtit ligj, të ardhurat modeste ishin një kusht thelbësor për të përfituar kredi hipotekore për blerje nga tregu i lirë.

61. Edhe Udhëzimi nr. 6257/2008, i dalë në zbatim të ligjit të sipërpërmendur, në pikën 5, parashikonte se përfitojnë kredi me kushte lehtësuese, vetëm familjet që: *a) nuk disponojnë banesë në pronësi, ose banojnë nën normat e strehimit, të përcaktuara në VKM-në nr. 814, datë 03.12.2004; b) kanë të ardhura familjare mujore, brenda kufijve që përcaktohen nga ministria që mbulon fushën e strehimit, në bashkëpunim me bankën.* Sipas pikës 6 të këtij udhëzimi, mosplotësimi i dy kushteve të mësipërme përbënte kriter skualifikues.
62. Nga aktet e administruara në fashikull, të referuara si më sipër në vendim, trupi gjykues konstatoi se, në momentin e aplikimit dhe të përfitimit të kredisë në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpronar me prindërit dhe vëllanë në pasurinë “apartament dhe truall”, të ndodhur në Berat. Sa i përket të ardhurave të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, në momentin e aplikimit dhe përfitimit të kredisë, rezulton se, për vitin 2012, ata kanë pasur të ardhura vjetore nga pagat, në vlerën 1.387.000 lekë. Nga verifikimi i formulës së përlllogaritjes së kufirit maksimal të të ardhurave, për të përfituar kredi me kushte lehtësuese, e përcaktuar në lidhjen “C” të ligjit nr. 9232/2004, në mënyrë që subjekti të kualifikohej për të përfituar kredinë me kushte lehtësuese, maksimumi i të ardhurave duhet të ishte 57.454 lekë në muaj. Në rastin konkret, trupit gjykues i rezultoi se të ardhurat mujore të familjes së subjektit të rivlerësimit kanë qenë rreth 115.600 lekë, dyfishi i maksimumit të përcaktuar nga ligji, duke mos plotësuar kriterin e të ardhurave të ulëta, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9232/2004.
63. Në përfundim, për sa më sipër, trupi gjykues çmon se, është i bazuar konstatimi i Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, se subjekti i rivlerësimit ka përfituar kredinë për blerjen e apartamentit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9232/2004”), si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Nga aktet e administruara në fashikullin e Komisionit, që i përkasin aplikimit të subjektit të rivlerësimit për kredi të butë në Bashkinë Fier, konstatohet se, në formularin e aplikimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ka pasuri në pronësi/bashkëpronësi. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pavërtetë dhe që nuk i përgjigjej situatës faktike në momentin e aplikimit, pasi në atë moment ka pasur në bashkëpronësi pasuritë “apartament” dhe “truall” në Berat. Trupi gjykues vlerësoi se deklarata noteriale e nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në datën 01.02.2013, nëpërmjet së cilës u premtonte prindërve shitjen në të ardhmen, të pjesës së tij takuese në pasurinë në bashkëpronësi në Berat, duket se ka pasur për qëllim që, përpara disbursimit të kredisë, të plotësoheshin kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për përfitimin e kredisë së butë për banesa në tregun e lirë nga programet sociale të strehimit, konkretisht të mospasjes pasuri në pronësi, përfshirë ato të përfituara nga procesi i privatizimit. Gjithashtu, nga dokumentacioni i aplikimit, rezulton se, në momentin e përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese, me vendim të Këshillit Bashkiak Fier, në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë pasur të ardhura thuajse sa dyfishi i tavanit të të ardhurave të përcaktuara si kriter në lidhjen “C” të ligjit nr. 9232/2004. Subjekti i rivlerësimit, edhe pse nuk plotësonte këtë kriter ligjor, ka vijuar procedurën për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese nga programe të dedikuara për individë/familje, që janë në pamundësi për të përballuar nevojat për strehim me të ardhurat e tyre. Deklarimet e pavërteta të subjektit në aplikimin për kredi të butë, sa i përket pasurisë në pronësi/bashkëpronësi, si dhe vijimi

i procedurave prej tij, në kushtet kur nuk plotësonte kriteret e legjislacionit në fuqi për të ardhurat e ulëta, u mbajtën në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

64. Komisionerja Publike, në ankim, ka sjellë si rrethanë faktike, edhe konstatimin se, nga të dhënat që Furnizuesi i Shërbimit Universal (në vijim “FShU”), ka përcjellë në Komision rezulton se: (i) me gjeneralitetet Genci Sh. Mane, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. {\*\*\*}, në instancën Fier, dhe (ii) me gjeneralitetet Genci Mane (pa atësi), identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. {\*\*\*}, në instancën Fier. Rezulton se të dyja këto kontrata janë lidhur në vitin 2011, përkatësisht në kabinën “{\*\*\*} {\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}”. Nga aktet në dosje, konstatohet se nuk është hetuar/kërkuar informacion në lidhje me kontrata të furnizimit midis subjektit dhe personave të lidhur, me Shoqërinë e Ujësjellës-Kanalizime ShA Fier.
65. Nga aktet e administruara në fashikull, si dhe nga deklaratimet e vetë subjektit gjatë hetimit administrativ në Komision, rezulton se ai ka filluar të banojë në apartament që në vitin 2010, dhe familja në vitin 2011, periudhë kohore që përkon edhe me lidhjen e kontratës për furnizim me energji elektrike në emrin e tij. Në pyetësorët drejtuar subjektit gjatë hetimit administrativ, dhe në rezultatet paraprake të hetimit, Komisioni nuk ka kërkuar sqarime në lidhje me kontratën e dytë që është me emrin e tij, por pa atësi, për rrjedhojë, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë sjellë ndonjë akt gjatë hetimit në Komision lidhur me këtë kontratë. Rezulton se Komisioni nuk ka kryer hetime të mëtejshme pranë Furnizuesit të Shërbimit Universal, lidhur me aktet që janë paraqitur/depozituar për lidhjen e kësaj kontrate furnizimi energjie elektrike, pra kontratë shitblerjeje, qiramarrjeje etj. Gjithashtu, konstatohet se Komisioni nuk ka kryer hetime pranë shoqërisë Ujësjellës-Kanalizimeve ShA Fier, për kontrata të furnizimit me ujë në emër të subjektit Genci Sh. Mane.
66. Në parashtrimet e paraqitura para seancës publike të datës 24.06.2025, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ka kërkuar nga OSSh-ja të kryhen verifikime mbi kontratat me emrin Genci Mane dhe, nga përgjigjja e kthyer nga ky subjekt me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 07.05.2025, informohet se, *nga verifikimi në sistemin e OSSh-së, në emër të Genci Mane, figuron kontratë me kod nr. {\*\*\*}, që furnizohet me energji elektrike nga kabina “{\*\*\*}”, {\*\*\*}. Kjo kontratë rezulton e pezulluar në sistem, me kërkesë nga abonentit. Nga verifikimi i kryer në terren, kjo kontratë nuk gjendet.*
67. Lidhur me gjetjen Komisioneres Publike, në vijim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, trupi gjykues, në seancën e datës 24.06.2025, vendosi që t’i drejtohet Furnizuesit të Shërbimit Universal Tiranë, dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria Rajonale Fier, për të marrë një informacion lidhur me historikun e abonentëve për kontratën me nr. {\*\*\*}, si dhe shoqërisë “Ujësjellës-Kanalizimeve” ShA Fier për kontrata të furnizimit me ujë në emër të subjektit Genci Sh. Mane, si dhe kontrata të furnizimit me ujë të njësisë së sipërpërmendur.
68. Nga përgjigjet e kthyera nga subjektet e sipërpërmendura, rezultojnë të dhënat si vijon:
- 68.1. FShU-ja, me shkresat nr. {\*\*\*} prot., datë 10.07.2025, dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 18.07.2025, ka informuar se, referuar të dhënave në sistemin e faturimit, kontrata nr. {\*\*\*}, me kod klienti “{\*\*\*}”, i përket abonentit Genci Mane, e hapur më datë 28.10.2011 në instancën Fier, me statusin “e pezulluar”. Në lidhje me kërkesën për kopje të kontratës, rezulton se nuk disponohet në arkiv.

Sipas të dhënave në sistemin e faturimit, rezulton se konsumatorët nuk kanë qenë të detyruar të paraqesin të dhëna të detajuara personale dhe janë të regjistruar vetëm me emër dhe mbiemër, dhe jo me atësi. Bashkëlidhur shkresave, janë dërguar edhe kopje të formularit me të dhënat e abonentit, nga të cilat, rezulton se, për abonentin Genci Mane, me kod klienti {\*\*\*}, i kategorisë abonent familjar *përdhes*, lidhja i përket {\*\*\*}, kabina “{\*\*\*}”. Sipas të dhënave të pagesës, për kontratën me nr. {\*\*\*}, në emër të abonentit Genci Mane, rezulton një faturë për muajin mars 2012, në vlerën 37.232,72 lekë, përfshirë kamatëvonesat.

68.2. Sipas shkresave nr. {\*\*\*} prot., datë 30.06.2025, dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 21.07.2025, të OSSh-së, në përgjigje të kërkesës së Kolegjit për vënien në dispozicion të akteve në bazë të të cilave është lidhur kontrata me nr. {\*\*\*}, informohet se në arkivin e Drejtorisë Rajonale Fier nuk ekzistojnë kopje kontrate dhe akte, në bazë të të cilave është lidhur kontrata e furnizimit me energji elektrike me nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, kabina “{\*\*\*}”, me abonent Genci Mane.

68.3. Sipas shkresave nr. {\*\*\*} prot., datë 30.06.2025, dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 21.07.2025, të shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime” ShA Fier, informohet se, nga të dhënat në sistemin *ALL - Billing*, në emër të Genci Sh. Mane rezulton një kontratë me shoqërinë Rajonale Ujësjellës - Kanalizime ShA, Fier, me nr. {\*\*\*}, me adresë lagjja “{\*\*\*}”, kontratë aktive e lidhur në datën 05.04.2017. Bashkëlidhur është dërguar një kopje e kontratës, si dhe të akteve shoqëruese për lidhjen e saj.

69. Lidhur me kontratën e furnizimit me energji elektrike, me nr. {\*\*\*}, në emër të abonentit Genci Mane, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, edhe pse bazuar në ankimin e ngritur nga Komisionerja Publike, gjatë gjykimit në Kolegj, në zbatim të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, kishte barrën e provës për të provuar se kjo kontratë nuk i përkiste atij, nuk arriti ta përmbysë atë, dhe të qartësojë situatën e dyshuar për një lidhje energjie për një pasuri në emër të tij.

70. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, nuk bëri asnjë përpjekje për të dokumentuar se ai nuk ishte abonenti në emër të të cilit ishte lidhur kjo kontratë, madje u shpreh indiferent për zbulimin e së vërtetës lidhur me të. Argumentet e tij në Kolegj për fiktivitet të kontratës së marrë në analizë, u konstatuan nga trupi gjykues si të pambështetura nga aktet e përcjella në Kolegj nga vetë subjekti, por dhe nga Furnizuesi i Shërbimit Universal ShA dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, Drejtoria Rajonale Fier. Sipas këtyre akteve, kontrata e sipërcituar ka qenë e regjistruar/evidentuar në sistem vetëm në një emër, atë të abonentit Genci Mane, deri në momentin që është pezulluar me kërkesë të abonentit (pra, Genci Mane). Gjithashtu, nga aktet e përcjella nga këto shoqëri gjatë hetimit në Kolegj, rezultoi se për këtë kontratë ka pasur faturim energjie elektrike në muajin mars të vitit 2012, në një vlerë të konsiderueshme, që duket si vlerë e besueshme për një njësi/abonent në katin *përdhes*, që mund t’i përgjigjet një njësie shërbimi, dhe jo një abonenti familjar tipik/standard.<sup>15</sup>

71. Mosgjetja e kësaj kontrate në terren, në momentin e kontrollit/mbajtjes së procesverbalit, siç referohet nga shkresa e OSSh-së, nuk provon fiktivitetin e kontratës apo mosekzistencën e saj, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, më së paku deri në momentin që është pezulluar me kërkesën e

---

<sup>15</sup> Sipas kartelës së përcjellë nga FShU-ja, rezulton abonent familjar *përdhes*.

abonentit Genci Mane. Në vlerësimin e kësaj rrethane, të sjellë në vëmendje në ankimin e Komisioneres Publike, trupi gjykues gjeti me rëndësi edhe të dhënat e referuara në aktet e FShU-së dhe OSSh-së, të administruara në fashikullin e çështjes, sipas të cilave kontrata me emër abonentit “Genci Mane” ka qenë e lidhur me kabinën elektrike “{\*\*\*}”, me numër rendor pas kabinës elektrike “{\*\*\*} {\*\*\*}”, me të cilën është lidhur kontrata për apartamentin në Fier, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

72. Në konsideratë të sa më sipër, trupi gjykues thekson se, edhe në kuadër të gjykimit të kësaj çështjeje në Kolegj, mbeti e paqartë situata faktike për këtë kontratë energjie elektrike dhe lidhja e subjektit të rivlerësimit me të. Pavarësisht kësaj paqartësie, trupi gjykues i mbajti në konsideratë problematikat si më sipër referuar, në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.
73. Lidhur me përdorimin e automjeteve në pronësi të të tretëve, Komisionerja Publike, në ankimin parashtron se, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim disa automjete në pronësi të të tretëve dhe, më konkretisht: (i) automjetin e markës “Mercedes-Benz”, modeli “E320 CDI”, me targë “{\*\*\*}”, automjetin e markës “Mercedes-Benz”, modeli “ML 280 CDI”, me targë “{\*\*\*}”, në pronësi të shtetasit M. R.; (ii) automjetin e markës “Volkswagen”, me targë “{\*\*\*}”, në pronësi të shtetasit R. Ç.; (iii) automjetin me targë “{\*\*\*}”, në pronësi të shtetasit M. Xh.; automjetin me targë “{\*\*\*}”, në pronësi të shtetasit E. M.; (iv) automjetet me targa të huaja “{\*\*\*}”, “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}”. Për efekt të përdorimit të automjeteve, listuar në pikën (i), me targë “{\*\*\*}”, dhe pikën (ii), trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka prerë tri polica sigurimi (TPL). Nga verifikimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, konkretisht të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS, konfirmohet se subjekti dhe/ose familja e tij kanë kaluar kufirin shqiptar me këto automjete në rreth 17 raste, në periudhën prej vitit 2012 deri në maj të vitit 2022, për të cilat ai nuk ka deklaruar përdorimin e tyre në deklaratimet periodike të interesave pasurorë vjetorë (në vitet përkatëse) dhe në deklaratën *vetting*. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjeve të drejtuara në pyetësorin standard dhe pyetësorin e datës 08.06.2022, konfirmon përdorimin e automjeteve të listuara në pikat (i) deri (iii), duke mos konfirmuar ato me targa të huaja të listuara në pikën (iv). Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, ka shpjeguar në përgjigjet e tij se përdorimin e automjeteve e ka pasur të përkohshëm, kryesisht për dalje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe se këta shtetas janë persona që, në dijeni të tij, kanë sjellje dhe qëndrim të mirë shoqëror dhe se ai nuk ka ndjekur çështje penale në ngarkim të tyre. Nga informacione që aksesohen në burime *open sources*, rezultojnë dy episode me të dhëna problematike në drejtim të shtetasve me të cilët subjekti ka marrëdhënie shoqërore dhe ka përdorur automjetet e tyre. Referuar korrespondencës me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, rezultoi edhe një gjobë e datës 01.09.2021 për automjetin me targë “{\*\*\*}”, me kundërvajtës personin e lidhur, znj. O. M.
74. Sipas Komisioneres Publike, për sa trajtuar më lart, për efekt të përdorimit të këtyre automjeteve, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaratimit të pasaktë e të pamjaftueshëm për sa parashikon neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, dhe neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me mosdeklarimin e interesit pasuror në formën e përdorimit të automjeteve, situatë kjo që, po ashtu, afekton edhe në drejtim të vlerësimit të standardit të integritetit dhe etikës së magjistratit prokuror.

75. Lidhur me sa ka konstatuar Komisionerja Publike, trupi gjykues vëren se, në deklaratën *vetting*, si dhe në deklaratat periodike vjetore, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar përdorimin e automjeteve të përmendura më sipër. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në pronësi një automjet tip “Opel”, blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.12.2015.
76. Në pyetësin standard, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nëse ka pasur ndonjëherë në përdorim prona të regjistruara në emër të dikujt tjetër, ka shpjeguar se: *“Kam përdorur për udhëtimet jashtë shtetit automjetet me targë ‘{\*\*\*}’, në pronësi të shtetasit E. M., në periudhën 26.03.2012 – 01.04.2012; me targë ‘{\*\*\*}’, në pronësi të shtetasit M. R., në periudhat gusht 2013, mars 2014, shkurt dhe gusht 2015, si dhe në periudha të shkurtra të cilat nuk më kujtohen; me targë ‘{\*\*\*}’, në pronësi të shtetasit M. Xh., në periudhën 22.08.2016 – 30.08.2016; me targë ‘{\*\*\*}’, në pronësi të shtetasit R. Ç., në periudhat gusht dhe shtator 2018, dhe gusht 2019, si dhe në periudha të shkurtra të cilat nuk më kujtohen”*. Në pyetësin nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, me personat të cilëve u ka marrë në përdorim të përkohshëm automjetet, ka qenë në marrëdhënie shoqërore dhe qëllimi ka qenë përdorimi i mjeteve, kryesisht për daljet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pasi mjetet që ka pasur dhe ka në pronësi nuk janë në gjendje teknike për të realizuar udhëtimet me largësi të konsiderueshme.
77. Komisioni, në kuadër të kontrollit të kriterit të figurës, nisur nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në pyetësin standard, ka hetuar lidhur me përdorimin nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, të disa automjeteve në pronësi të personave të tretë. Referuar akteve të ndodhura në fashikujt e Komisionit, lidhur me përdorimin e automjeteve të përmendura në ankimin e Komisioneres Publike, rezultojnë këto të dhëna:
- 77.1. Bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, rezulton se subjekti ka dalë jashtë vendit me familjen dhe, në disa raste, me persona të tjerë, me automjetet me targa “{\*\*\*}” në pronësi të shtetasit R. Ç., “{\*\*\*}” në pronësi të shtetasit M. R., “{\*\*\*}”, në pronësi të shtetasit M. Xh. dhe, “{\*\*\*}”, në pronësi të shtetasit E. M., si dhe me disa automjete me targa të huaja.<sup>16</sup>
- 77.2. Komisioni ka hetuar lidhur me përdorimin nga subjekti të automjeteve me targë “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}”. Pas kërkesës së Komisionit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 03.08.2022, ka paraqitur informacion lidhur me mbulimin me sigurim të këtyre mjeteve motorike. Nga ky informacion, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë policëmbajtës/përdorues i kartonit jeshil (sigurim i detyrueshëm për udhëtimet jashtë shtetit): i) për automjetin me targa {\*\*\*}, në periudhën 12.08.2019 – 26.08.2019, së bashku me pronarin dhe përdoruesin e automjetit, shtetasin R. Ç.; ii) për automjetin me targa {\*\*\*}, për periudhën

<sup>16</sup> Me automjetin me targë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar 5 herë (vajtje-ardhje), për periudhën 30.08.2018 – 15.05.2022; me automjetin me targë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar 4 herë (vajtje-ardhje), për periudhën 24.08.2013 – 26.08.2015; me automjetin me targë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar 1 herë (vajtje-ardhje), në datat 22.08.2016 – 30.08.2016; me automjetin me targë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar 1 herë (vajtje-ardhje), në datat 26.03.2012 - 01.04.2012; me automjetin me targë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar 1 herë (vajtje-ardhje), në datën 02.06.2012; me automjetin me targë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar 1 herë (vajtje-ardhje), në datat 13.05.2010 – 14.05.2010; me automjetin me targë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar 1 herë (vetëm dalje), në datën 01.08.2008; me automjetin me targë {\*\*\*}, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar 1 herë (vetëm hyrje), në datën 07.09.2008.

27.02.2015 – 13.03.2015, së bashku me pronarin e automjetit, shtetasin M. R., dhe; për periudhën 24.08.2013 – 07.09.2013, si përdorues i vetëm.

77.3. Komisioni i ka kërkuar informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me qëllim verifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka ndjekur ndonjë procedim penal lidhur me shtetasit që rezultojnë pronarë të automjeteve të sipërcituara, e cila ka informuar<sup>17</sup> se, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur nën hetim/procedime penale, në ngarkim të këtyre shtetasve. Pas kërkesës së Komisionit lidhur me ndonjë çështje penale të mundshme ndaj shtetasve R. Ç. dhe M. R., Prokuroria e Posaçme ka informuar<sup>18</sup> se, pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale, ndaj këtyre dy shtetasve nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

77.4. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dërguar informacion<sup>19</sup>, sipas të cilit: *Automjeti me targë {\*\*\*} ka gjithsej 5 masa administrative për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Pronar i këtij mjetei rezultoi shtetasi A. K. Nuk u konstatua marrja e ndonjë mase administrative ndaj subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur, si përdorues i këtij mjetei. Automjeti me targë {\*\*\*} ka gjithsej 11 masa administrative. Pronar i këtij mjetei rezultoi shtetasi R. Ç. Për këtë mjet, rezultoi se bashkëshortja e subjektit, O. M., ka marrë masë administrative, si përdoruese e mjetei më datë 01.08.2021, në vlerën 1.000 lekë.*

78. Në parashtrime, si dhe gjatë seancave gjyqësore të zhvilluara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si edhe në Komision, duke sqaruar se përdorimi i automjeteve ka qenë pothuajse për udhëtimet jashtë vendit, pasi ai vetë nuk ka pasur një automjet që të plotësonte parametrat teknikë. Sipas tij, përdorimi afatshkurtër i automjeteve, në këtë rast, nuk mund të klasifikohet si interes pasuror, që mbart detyrimin për deklarim. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se nuk mund të flitet për shkelje të standardeve të etikës dhe integritetit nga ana e tij, në kushtet kur, nga hetimet e zhvilluara në Komision, rezultoi se pronarët e automjeteve nuk kanë pasur çështje penale në ngarkim.

79. Nga të dhënat e referuara më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim brenda periudhave relativisht të gjata kohore, në mënyrë të përsëritur, automjetet me targa {\*\*\*} dhe {\*\*\*}, të cilat nuk kanë qenë në pronësi të tij apo të familjarëve. Fakti i përdorimit të vazhdueshëm të këtyre automjeteve nga subjekti dhe familja e tij vërtetohet, si nga vetë deklaratat e subjektit gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu dhe nga të dhënat e akteve të dërguara nga institucionet shtetërore. Periudhat e përdorimit të automjeteve shtrihen në periudhën para deklaramit *vetting*, ashtu dhe më pas, siç rezultoi nga masa administrative e marrë nga bashkëshortja më datë 01.08.2021, si përdoruese e automjeti me targë {\*\*\*}, për të cilin subjekti ka deklaruar në pyetësorin standard se e ka pasur në përdorim në periudhat gusht dhe shtator 2018, dhe gusht 2019, si dhe në periudha të shkurtra, të cilat nuk i kujtohen.

80. Në ndryshim nga sa ka pretenduar në ankim Komisionerja Publike, trupi gjykues konstaton se policat e sigurimit që kanë qenë në emër të subjektit të rivlerësimit janë për udhëtimet jashtë shtetit

<sup>17</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 29.07.2022.

<sup>18</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.11.2022.

<sup>19</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.10.2022.

(karton jeshil), për periudha 15-ditore, dhe jo siç parashtrahet prej saj, si polica të tipit “TPL”<sup>20</sup>. Trupit gjykues i rezultoi se këto polica sigurimi 15-ditore, për automjetin me targë {\*\*\*} janë për periudhën 24.08.2013 – 07.09.2013, dhe për periudhën 27.02.2015 – 13.03.2015, ndërsa për automjetin me targë {\*\*\*}, për periudhën 12.08.2019 – 26.08.2019. Në referim të sa më sipër, trupit gjykues i rezultoi se, në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë policë sigurimi në emrin e tij për përdorim të këtyre automjeteve, si dhe nuk ka asnjë akt të administruar në dosje, që të provojë përdorimin e një automjeti tjetër, përveç atij që kishte në pronësi. Gjithashtu, rezultoi se, momenti më i afërt në kohë me dorëzimin e deklaratës *vetting*, ka qenë përdorimi i automjetit me targë {\*\*\*} në periudhën 22.08.2016 – 30.08.2016, automjet të cilin e ka përdorur vetëm në këtë udhëtim, sipas sistemit TIMS dhe, për të cilin, nuk ka të dhëna nga aktet nëse ka pasur policë sigurimi në emrin e vet.

81. Për sa më sipër, lidhur me përdorimin e automjeteve në pronësi të të tretëve, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte këtë marrëdhënie në deklaratat periodike të pasurisë të viteve në të cilat ai ka pasur në përdorim këto automjete, veçanërisht për ato automjete për të cilat ka pasur polica sigurimi në emrin e tij. Pavarësisht këtij konkluzioni, në kuadër të procesit të rivlerësimit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur një marrëdhënie përdorimi në kohën e dorëzimit të deklaratës *vetting*, pasi, referuar akteve të administruara në Komision, nuk rezultojnë të dhëna që automjetet të kenë qenë në përdorim prej tij dhe familjarëve, në kohën e përpilimit dhe dorëzimit të kësaj deklarate në datën 27.01.2017. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se është i pabazuar pretendimi i Komisioneres Publike dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në konkluzionet përfundimtare, se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm, për sa parashikon neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, dhe neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, për mosdeklarimin e interesit pasuror, në formën e përdorimit të automjeteve.
82. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka përdorur në një periudhë të shtrirë kohore prej së paku 14 vitesh, në një numër të konsiderueshëm rastesh, automjete në pronësi të personave të tjerë (8 automjete). Nga aktet e administruara, rezultoi se për 3 (tri) prej tyre<sup>21</sup>, subjekti nuk ka dhënë shpjegime të plota në pyetësonin standard dhe gjatë hetimeve në Komision, si edhe gjatë gjykimit në Kolegj, duke mos përcjellë informacion lidhur me identitetin e pronarëve të tyre, rrethanat e njohjes me ta, elemente këto që mund t’i nënshtroheshin kontrollit në kuadër të këtij procesi. Kjo sjellje e subjektit të rivlerësimit, në raport me përdorimin e automjeteve në pronësi të personave të tjerë, e cila vlerësohet se nuk përputhet me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit jashtë funksionit dhe në jetën private, u mbajt në konsideratë nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor të çështjes, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>20</sup> Polica “TPL” është siguracioni i detyrueshëm i mjetit me targë shqiptare, për qarkullim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe që lëshohet për një periudhë 1-vjeçare, edhe sipas parashikimeve të legjislacionit të kohës në fjalë, ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

<sup>21</sup> Automjete me targa të huaja.

***B/2 Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale***

83. Komisionerja Publike, në ankimin drejtuar Kolegjit, parashtron se për kriterin e vlerësimit profesional, bazuar në indikatorët vlerësues, të parashikuar nga nenet 71 - 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 96/2016”), për subjektin e rivlerësimit konstatohen disa raste me mangësi, të tilla që nuk pajtohen me pritshmërinë se prokurori duhet të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe ndërmarrjes së hetimeve të shpejta dhe të plota, të gjithanshme dhe objektive, me qëllim arritjen e një përfundimi të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe prova. Këtë qëndrim, Komisionerja Publike e ka arritur bazuar në dy denoncime të paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit, të cilat u analizuan nga trupi gjykues si më poshtë.
84. Lidhur me denoncimin e depozituar në Komision nga shtetasi A. S., Komisionerja Publike, në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*}/2020, në raport me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim për rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, nenet 71 - 74 të ligjit nr. 96/2016, ndan qëndrim të ndryshëm me përfundimin e arritur nga Komisioni. Mangësitë e vërejtura duken të natyrës përsëritëse, në drejtim të ndërmarrjes së hetimeve logjike dhe efektive, të respektimit të urdhërimeve të lëna nga gjykata, si dhe të mangëta për sa i përket kualifikimit, sipas paragrafit 2, të nenit 236, të Kodit Penal, ku si elemente të anës objektive paraqiten bashkëpunimi, dhuna fizike apo përsëritja më shumë se një herë, të cilat nuk rezultojnë sipas akteve në dosjen e fashikullit penal. Po ashtu, Komisioni është i paqartë dhe i pashpjegueshëm lidhur me konsideratën se “ndodhemi përpara gjësë së gjykuar”. Të njëjtin qëndrim mbajti dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në bisedimet përfundimtare, në mbështetje të shkakut të ankimit gjatë gjykimit në Kolegj.
85. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, kundërshtoi shkakun e ankimit, duke parashtruar se çështja penale që referon denoncuesi i është nënshtruar kontrollit gjyqësor. Zbatimi i dispozitave materiale dhe procedurale janë attribute vetëm të prokurorit përkatës dhe të gjyqtarit të çështjes, ndërkohë që zbatimi i gabuar i ligjit nuk mund të përbëjë shkak në çdo rast, kur nuk provohet ana subjektive, për procedim disiplinor, pasi, në çdo mënyrë, do të cenohej pavarësia dhe objektiviteti i gjykatave.
86. Komisioni ka marrë në shqyrtim denoncimin e shtetasit A. S., i cili ka ngritur pretendime për veprime antiligjore të subjektit të rivlerësimit për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tij. Komisioni, pas kërkesës drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, ka administruar dosjen lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*} në maj të vitit 2020. Pas administrimit të kësaj dosjeje, duke referuar edhe vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni ka arritur në përfundimin se nuk rezultuan indicie për shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimit gjatë veprimtarisë së tij për këtë procedim penal, dhe se ndodhemi përpara “gjësë së gjykuar”.
87. Nga analiza e të dhënave që rezultojnë nga aktet e procedimit penal të administruara nga Komisioni, dhe nga aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit në Kolegj, trupi gjykues konstatoi si vijon:

87.1. Në datën 30.04.2020, në bulevardin “{\*\*\*}”, në Fier, shtetasi A. S. i është nënshtruar kontrollit nga punonjësit e policisë, të cilët i kanë kërkuar letërnjoftimin, si dhe lejen e lëvizjes (për shkak të gjendjes së vendosur nga COVID-19). Ky shtetas ka kundërshtuar punonjësit e policisë, duke mos paraqitur dokumentet e kërkuara dhe duke drejtuar fjalë fyese ndaj tyre. Punonjësit e policisë kanë kryer veprime për mbajtjen në kontroll të këtij shtetasi deri në ardhjen e patrullës së policisë. Në momentin e ardhjes së patrullës, shtetasi A. S. ka kundërshtuar shoqërimin, duke shtyrë me duar punonjësit e policisë, madje, edhe pasi është futur në automjetin e policisë, ka vazhduar të drejtojë fjalë fyese ndaj punonjësve të policisë, duke i shtyrë brenda mjetit. Edhe në momentin e mbërritjes në ambientet e komisarariatit të policisë, ky shtetas ka vijuar të drejtojë fjalë fyese ndaj punonjësve të policisë, duke i filmuar këta të fundit me celular, dhe duke i kundërshtuar kur i kanë marrë celularin.

87.2. Bazuar në materialin kallëzues të policisë, subjekti i rivlerësimit, si prokurori i çështjes, më datë 01.05.2020 ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236, paragrafi 2 i Kodit Penal, si dhe shënimin në regjistër të emrit të shtetasis A. S.

87.3. Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me vendimin nr. {\*\*\*}, të datës 21.01.2021, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë Fier, me objekt “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. {\*\*\*}, të vitit 2020”, me të pandehur shtetasin A. S., akuzuar për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i Kodit Penal, ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë, duke e urdhëruar të plotësojë hetimet, si dhe përfundimin e hetimeve të ngarkuara nga Gjykata brenda një afati 30-ditor.

87.4. Me vendimet e datave 18.10.2021, 18.01.2022 dhe 18.04.2022, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, ka vendosur shtyrjen e afateve të hetimit për këtë procedim penal dhe, më datë 08.07.2022, çështja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier.

87.5. Denoncuesi ka paraqitur pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”) ankesë ndaj veprimtarisë hetimore të subjektit të rivlerësimit. Pas shqyrtimit të kërkesës, ILD-ja, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.1.2021, ka vendosur arkivimin e kërkesës së paraqitur nga denoncuesi, pasi ka vlerësuar se, për subjektin e rivlerësimit nuk ngrihen dyshime të arsyeshme se sjellja apo veprimet e tij janë të natyrës së tillë, që të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit në fuqi.

88. Lidhur me konstatimin e Komisioneres Publike se, për këtë procedim penal, mangësitë e vërejtura duken të natyrës përsëritëse, në drejtim të ndërmarjes së hetimeve logjike dhe efektive, nga shqyrtimi i akteve që kanë të bëjnë me veprimet procedurale dhe hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të këtij procedimi, rezulton se:

88.1. Materiali kallëzues për shtetasin A. S. është përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier, më datë 01.05.2020, dhe, po në këtë datë, subjekti ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236, paragrafi 2 i Kodit Penal, si dhe shënimin në regjistër të emrit të shtetasis A. S., sipas parashikimeve të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale.

**88.2.** Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 03.05.2020, Gjykata e Shkallës së Parë Fier ka vendosur vlerësimin të ligjshëm të arrestit në flagrancë, dhe caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, për personin nën hetim A. S., vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë.

**88.3.** Subjekti i rivlerësimit, më datë 04.05.2020, ka nxjerrë urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore, duke përcaktuar se, për një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, është e nevojshme kryerja e këtyre veprimeve: (i) të këqyret aparati celular, sekuestruar personit nën hetim, nëse ka regjistruar pamje filmike nga momentet e komunikimit me punonjësit e policisë ditën e ngjarjes; (ii) të pyeten si deklarues punonjësit e policisë, në lidhje me ngjarjen, për veprimet e personit nën hetim dhe të personave të pranishëm; (iii) të pyeten punonjës të tjerë në komisariatit e policisë Fier, në momentin kur është kryer shoqërimi i personit nën hetim; (iv) të verifikohet pranë komisariatit të policisë nëse ndaj personit nën hetim është vendosur masë administrative për shkelje të aktit normativ, për kufizimin e lëvizjes dhe marrjen e lejes përkatëse; (v) të pyeten si deklarues persona të cilët kanë dijeni rreth ngjarjes; (vi) të kryhen veprime të tjera hetimore të cilat do të rezultojnë të domosdoshme. Këto veprime hetimore, të kryhen brenda datës 30.05.2020.

**88.4.** Sipas procesverbaleve të datave 30.04.2020 dhe 21.05.2020, janë marrë të dhënat nga persona që kanë dijeni për veprën penale, punonjësit e policisë, D. B. dhe H., si dhe punonjësit e policisë së patrullës së shoqërimit, J. M. dhe L. F.

**88.5.** Me vendimin e datës 13.05.2020, subjekti i rivlerësimit ka vendosur këqyrjen e aparateve regjistruese (kamerave) të subjekteve tregtare në vendin ku ka ndodhur ngjarja, veprim i cili duhet të kryhej nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, brenda datës 14.05.2020. Më datë 13.05.2020, është bërë këqyrja e pajisjes *DVR* të një prej njësisve tregtare, në prani të OPGJ-së dhe specialistes së IT-së të prokurorisë, dhe është bërë fiksimi dhe printimi i pamjeve filmike.

**88.6.** Më datë 26.05.2020, është kryer këqyrja e aparatit celular që i është sekuestruar të pandehurit në momentin e shoqërimit, në ambientet e komisariatit, por, për shkak se i pandehuri nuk mbante mend kodin, këqyrja nuk u realizua. Me urdher të prokurorit, më datë 29.10.2020, i është kthyer të pandehurit aparati celular.

**88.7.** Me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 13.05.2020, Komisariati i Policisë Fier ka dërguar vendimin nr. {\*\*\*}, datë 01.05.2020, për vendosjen e masës administrative në lidhje me shkeljen e aktit normativ nr. 3, datë 15.03.2020, nga shtetasi A. S.

**88.8.** Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 01.08.2020, ka përshkruar kryerjen e veprimeve hetimore të këqyrjes së pamjeve filmike, të regjistruara nga një subjekt privat, dhe pyetjen e punonjësve të policisë, si dhe ka vendosur shtyrjen e afateve të hetimit deri më datë 01.11.2020.

**88.9.** Me aktin “Njoftim për përfundimin e hetimeve”, të subjektit të rivlerësimit, të datës 23.10.2020, është njoftuar dhe ka marrë dijeni personi në hetim, të cilit i janë bërë me dije edhe të drejtat e tij.

**88.10.** Sipas procesverbaleve të datave 11.09.2020 dhe 18.09.2020, janë pyetur si persona që kanë dijeni për veprën penale, punonjësit në shërbim në ambientet e jashtme të dhomave të shoqërimit në komisariat, A. A. dhe A. H.

88.11. Sipas shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 17.11.2020, të Drejtueses së Prokurorisë Fier, është përcjellë në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020.

88.12. Gjykata e Shkallës së Parë Fier, pas zhvillimit të seancës paraprake, me vendimin nr. {\*\*\*}, të datës 21.01.2021, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit të çështjes, duke e urdhëruar për kryerjen e veprimeve hetimore brenda një afati 30-ditor. Gjykata ka arritur në këtë qëndrim, pasi ka konstatuar se: (i) Organi procedues duhet të kishte caktuar një ekspert të pavarur të fushës së teknologjisë, në mënyrë që të asistonte në këqyrjen e provës elektronike, me qëllim verifikimin e deklarimeve të kallëzuesve, por edhe pohimin e të pandehurit se ai po filmonte punonjësit e policisë në momentin që e kishin ndaluar. Kur prova materiale i është kthyer sërish të pandehurit, këqyrja e mëvonshme e saj cenon rëndë vlerën provuese të provës, por edhe vërtetësinë në marrjen e saj. (ii) Nga organi procedues, rezultoi të jetë realizuar këqyrja e kamerave të sigurisë në një dyqan të ndodhur në vendngjarje. Këqyrja e pamjeve filmike është shoqëruar edhe me tabelë fotografike bardhezi. Gjykata çmon se organi procedues duhej të procedonte me marrjen e një kopjeje të pamjeve filmike, me regjistrim në *CD*. Prova janë pamjet filmike, prandaj ato duhej të administroheshin edhe në regjistrim filmik. (iii) Gjykata vlerëson se organi i prokurorisë duhet të ripyese veçmas dy punonjësit e policisë, D. B. dhe H. K., duke administruar saktësisht deklaratimet e tyre me ngjarjen në procesverbalin përkatës. (iv) Nëse gjatë hetimeve, del e nevojshme kryerja e veprimeve hetimore shtesë, prokurori, në funksion të zbatimit të ligjshmërisë, duhet të ndër marrë të gjithë hapat e nevojshëm proceduralë në kuadër të një hetimi të plotë dhe të thelluar.

89. Pas vendimit të mësipërm të gjyqtarit të seancës paraprake, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer këto veprime të tjera hetimore:

89.1. Sipas procesverbalit të datës 16.02.2021, është kryer këqyrja e kamerave të sigurisë të ambienteve të dyqanit të shtetasit I. S., nga Oficeri i Policisë Gjyqësore dhe specialistja e IT-së, B. M., dhe është konstatuar se nuk janë ruajtur në memorie pamjet filmike të ngjarjes.

89.2. Sipas procesverbaleve të datave 19.02.2021 dhe 22.02.2021, janë pyetur përsëri si persona që kanë dijeni për veprën penale, punonjësit e policisë D. B. dhe H. K.

89.3. Sipas procesverbalit të datës 16.02.2021, është pyetur specialistja e IT-së, B. M., si person që ka dijeni për veprën penale, lidhur me veprimet e kryera për këqyrjen e kamerave në njësitë tregtare në vendin e ngjarjes.

89.4. Sipas procesverbalit të datës 16.02.2021, është pyetur shtetasi I. S. si person që ka dijeni për veprën penale, lidhur me veprimet e kryera për këqyrjen e kamerave në njësinë e tij tregtare, në vendin e ngjarjes.

89.5. Sipas procesverbalit të datës 23.02.2021, është pyetur shtetasi R. P. si person që ka dijeni për veprën penale, lidhur me veprimet e kryera për këqyrjen e kamerave në njësinë e tij tregtare, në vendin e ngjarjes.

89.6. Nga subjekti, është marrë vendimi për sekuestrimin përsëri të provës materiale, celularit të të pandehurit, dhe është zbatuar nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, më datë 05.05.2021, një vit pas ndodhjes së ngjarjes (sipas procesverbalit për sekuestrimin e provave materiale).

89.7. Me vendimin e datës 07.05.2021, Oficeri i Policisë Gjyqësore ka vendosur kryerjen e ekspertimit tekniko-elektronik të materialit filmik të regjistruar me aparatin celular të të pandehurit. Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.09.2021, nga Drejtuesja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, i është kërkuar Drejtorisë së Policisë Shkencore Tiranë, vënia në dispozicion e aktit të ekspertimit, dhe është ridërguar vendimi për kryerjen e ekspertimit.

89.8. Me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nr. {\*\*\*}, datë 05.07.2021, gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë, pasi nuk janë plotësuar detyrat e lëna prej gjykatës.

89.9. Me vendimin e datës 18.10.2021, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit deri më datë 18.01.2022, për shkak të domosdoshmërisë së kryerjes së veprimeve të tjera hetimore, konkretisht kryerjen e ekspertimit pranë Drejtorisë së Policisë Shkencore Tiranë.

89.10. Me vendimin e datës 18.01.2022, subjekti i rivlerësimit ka vendosur zgjatjen e afatit të hetimit deri më datë 18.04.2022, duke përcaktuar se është kryer akti i ekspertimit nga ekspertët, dhe del si domosdoshmëri kryerja e veprimeve të tjera hetimore, por pa i përcaktuar këto veprime. Nga aktet, nuk rezultojnë veprime hetimore të kryera gjatë periudhës së zgjatjes së afatit të hetimit.

89.11. Me vendimin e datës 18.04.2022, subjekti i rivlerësimit ka vendosur përsëri zgjatjen e afatit të hetimit deri më datë 18.07.2022, me të njëjtin argumentim si vendimi i mëparshëm, për shkak të domosdoshmërisë së kryerjes së veprimeve të tjera hetimore, por pa i përcaktuar këto veprime. Nga aktet, nuk rezultojnë veprime hetimore të kryera gjatë periudhës së zgjatjes së afatit të hetimit.

89.12. Në datën 08.07.2022, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar gjykatës me kërkesën për gjykimin e çështjes nr. {\*\*\*}/2020, me të pandehur shtetasin A. S.

90. Në analizë të shkakut të ankimit të Komisioneres Publike, në raport me prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe me situatën faktike të referuar si më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, për periudha të gjata kohore (për gati 6 muaj, për periudhën 18.01.2022 – 08.07.2022), nuk ka kryer veprime hetimore, si dhe ka marrë vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve, pa përcaktuar veprimet e nevojshme që duheshin kryer. Në vendimet për zgjatjen e afateve të hetimeve, subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar kërkesat e nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit, zgjatje të mëtejshme të afatit të hetimeve mund të bëhen nga prokurori, në rastin e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar në asnjë prej vendimeve të marra prej tij, se cila prej kërkesave të nenit 324, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale është përmbushur për të justifikuar zgjatjen e afateve të hetimit, në drejtim të argumentimit të kompleksitetit të çështjes, apo të pamundësisë objektive për të përfunduar hetimin brenda afatit të mëparshëm tremujor. Gjithashtu, konstatohet se, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përsëritur, nuk ka kryer veprimet hetimore që i janë lënë detyrë nga gjykata, siç rezulton në 2 (dy) vendime, me të cilat, nga gjykata, janë kthyer aktet e procedimit penal për plotësim të detyrave të lëna. Moskryerja e veprimeve hetimore të plota dhe shteruese, siç kanë konstatuar edhe gjykatat, si dhe zgjatjet e pajustificuara të afateve të hetimeve, kanë shkaktuar zvarritje në kryerjen e hetimeve dhe zgjidhjen e çështjes (që përfundimisht ka shkuar për gjykim, pas më shumë se dy vitesh nga momenti i regjistrimit të procedimit penal), situatë kjo, që duhet të ishte shmangur nga subjekti i rivlerësimit.

91. Gjithashtu, rezulton se marrja e vendimit për kryerjen e ekspertimit tekniko-elektronik të materialit filmik të regjistruar me aparat celular, më shumë se një vit pasi çështja i ishte caktuar subjektit, dhe pasi prova materiale i ishte kthyer të pandehurit, ka shkaktuar, ashtu siç ka konstatuar edhe gjykata, cenimin e rëndë të vlerës provuese të provës, por edhe vërtetësinë në marrjen e saj. Në sekuestrimin e parë të provës materiale, celularit të personit nën hetim, menjëherë pas ngjarjes, subjekti i rivlerësimit është mjaftuar me deklarin e këtij personi se nuk e mbante mend kodin e hapjes së aparatit, dhe nuk e ka thelluar hetimin, duke kërkuar kryerjen e ekspertimit. Ndërkohë, konstatohet edhe se subjekti ka vendosur sekuestrimin përsëri të provës materiale dhe kryerjen e ekspertimit tekniko-elektronik, më shumë se tre muaj pas vendimit të gjykatës, që konstatonte mangësi në kryerjen e këtyre veprimeve, situatë kjo, që ka prodhuar një shtyrje të mëtejshme, të pajustificuar të hetimeve.
92. Për rrjedhojë, për këtë procedim penal, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, për të ndërmarrë logjikisht hetimin dhe për të mbledhur provat, sipas nënindiktorit të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, mangësi që lidhen me mosveprimin e subjektit për një kohë të paarsyeshme, si dhe në drejtim të aftësisë për të kryer në mënyrë të efektshme veprimet e nevojshme hetimore, tregues që konsiderohen në kuadër të nënindiktorëve të aftësive organizative, në kuptim të nenit 74, pikat 1 dhe 4 të po këtij ligji.
93. Për sa i përket pretendimit të Komisioneres Publike se ka pasur mangësi nga subjekti në kualifikimin e veprës penale sipas paragrafit 2, të nenit 236, të Kodit Penal, konstatohet se neni 236, “Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik” parashikon se: *1. Kundërshtimi që i bëhet punonjësit të policisë së rendit publik, me qëllim për ta penguar atë për kryerjen e detyrës sipas ligjit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. 2. Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose duke ushtruar dhunë fizike ose më shumë se një herë, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në shtatë vjet.* Në vendimin për marrjen e personit si të pandehur, të datës 21.10.2020, subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se jemi përpara faktit se personi nën hetim, A. S., ka kryer veprime me qëllim për të kundërshtuar kryerjen e detyrës nga punonjësit e policisë, veprime këto, të cilat janë kryer duke përdorur fjalë fyese dhe veprime fizike ndaj tyre, fjalë dhe veprime të cilat janë kryer në mënyrë të vazhdueshme nga momenti i ndalimit, shoqërimit me automjet, dhe në ambientet e komisariatit të policisë. Sa më sipër, rezulton se me veprimet e tij, personi nën hetim, A. S., ka konsumuar elementet e veprës penale “Kundërshtimi i punonjësit të rendit publik”, të parashikuar nga neni 236, pika 2 e Kodit Penal. Ky kualifikim i veprës penale nuk është kundërshtuar nga gjykata në asnjë prej gjykimeve të zhvilluara, si për vendosjen e masës së sigurimit, ashtu dhe në seancat paraprake për gjykimin e çështjes. Nga të dhënat e akteve, rezulton se nuk qëndron konstatimi i Komisioneres Publike se, sipas akteve në fashikullin penal, nuk rezultojnë elementet e anës objektive, bashkëpunimi, dhuna fizike apo përsëritja. Është e vërtetë që, në akte nuk ka të dhëna për bashkëpunim apo përsëritje, por në to rezultojnë të dhëna për veprime aktive të të pandehurit për të kundërshtuar fizikisht dhe me fjalë fyese punonjësit e policisë, gjatë momentit të arrestimit dhe shoqërimit në komisariat, që, në këtë rast, do të përfshiheshin tek elementi i dhunës fizike të ushtruar ndaj punonjësit të rendit publik dhe, që kanë shërbyer si bazë për kategorizimin e veprës penale nga subjekti i rivlerësimit, sipas pikës 2 të nenit 236. Në këtë rast, mjafton edhe vetëm plotësimi i një prej elementeve të anës objektive, që vepra penale të kualifikohet sipas paragrafit 2 të nenit 236, pasi lidhëza “ose” nuk

kërkon plotësimin kumulativ të të tria elementeve. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk qëndron konstatimi i Komisioneres Publike për mangësi të subjektit të rivlerësimit në drejtim të kualifikimit të veprës penale.

94. Për sa i përket konstatimit të Komisioneres Publike, se Komisioni është i paqartë dhe i pashpjegueshëm lidhur me konsideratën se “ndodhemi para gjësë së gjykuar”, nga vendimi i Komisionit, prezumohet se Komisioni duhet të ketë arritur në këtë konkluzion, duke iu referuar vendimit të marrë nga ILD-ja lidhur me ankesën që shtetasi A. S., i pandehuri, ka bërë ndaj subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se ky konkluzion i Komisionit është i pabazuar, pasi procedimi disiplinor në ILD, dhe procesi i rivlerësimit kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, janë procedime të ndryshme dhe, të njëjtat fakte, mund t’u shërbejnë në mënyrë të pavarur për t’u shqyrtuar e vlerësuar në kuadër të këtyre procedimeve. Vendimmarrja e ILD-së, në kuadër të një hetimi për shkelje disiplinore, nuk mund të përjashtojë shqyrtimin e vlerësimit të njëjtës çështje nga organet e rivlerësimit, në kuadër të ligjit nr. 84/2016.
95. Lidhur me denoncimin e shtetasit A. B., Komisionerja Publike në ankim, si dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme gjatë gjykimit në Kolegj, parashetrojnë se, në vlerësim të akteve të administruara lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*/2020, ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, në raport me dispozitat ligjore që gjejnë zbatim për rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, nenet 71 - 74 të ligjit nr. 96/2016, ndajnë qëndrim të ndryshëm me përfundimin e arritur nga Komisioni. Kështu, në asnjë nga vendimet e zgjatjes së afateve të hetimit, nuk është përcaktuar lloji i veprimeve hetimore që do të kryhen, vendime të cilat, nga përmbajtja e akteve në dosjen e Komisionit, nuk rezultojnë t’u jenë njoftuar të dëmtuarit dhe të pandehurve. Po ashtu, Komisioni është i paqartë dhe i pashpjegueshëm lidhur me konsideratën se ndodhemi përpara “gjësë së gjykuar”.
96. Shtetasi A. B. i është drejtuar Komisionit me një denoncim ndaj subjektit të rivlerësimit, në të cilin pretendon se subjekti, si prokuror i çështjes në të cilën ai ka qenë i pandehur, ka zvarritur hetimet për më shumë se një vit, pa e njoftuar atë apo mbrojtësin ligjor për shtyrjen e hetimeve.
97. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, pas kërkesës së Komisionit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 14.07.2022, ka dërguar praktikën lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*/2020, me të pandehur A. B. Pas administrimit të dosjes së procedimit penal, si dhe pas konstatimit se denoncuesi ka paraqitur ankesë pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Komisioni, duke referuar edhe vendimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka arritur në përfundimin se nuk rezultuan indicie për shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimit nga ky denoncim, dhe se ndodhemi përpara “gjësë së gjykuar”.
98. Lidhur me procedimin penal nr. {\*\*\*/2020, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni rezulton se:
- 98.1. Me vendimin e datës 27.04.2020, subjekti i rivlerësimit, si prokuror i çështjes, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal me nr. {\*\*\*}, dhe shënimin në regjistër të emrit të shtetasit A. B., si personi të cilit i atribuohet kryerja e veprave penale “Kanosja” dhe “Prishja e qetësisë publike”, në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 84, 25 dhe 274/1, 25 të Kodit Penal. Regjistrimi i procedimit penal është bërë pasi, nga materiali kallëzues i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat Fier, ka rezultuar se, në datën 25.04.2020, ky shtetas, së bashku

me shtetasin D. R., janë arrestuar në flagrancë, pasi kanë ndaluar në qendër të qytetit Fier automjetin ku udhëtonte shtetasi Xh. O., ndaj të cilit kanë ushtruar dhunë fizike. Gjatë këtij momenti, shtetasi D. R., i cili mbante sendin “sqepar”, ka dëmtuar xhamin e përparmë dhe anësor të drejtuesit të mjetit. Sipas akteve, ditën e arrestimit, shtetasi A. B. ka qenë në detyrën e oficerit të patrullës së përgjithshme në Stacionin e Policisë Roskovec dhe, për këtë arsye, me vendim të drejtuesve të policisë, është pezulluar nga detyra deri në ndryshimin e statusit të tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

**98.2.** Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me kërkesë të prokurorit të çështjes, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.04.2020, ka vlerësuar të ligjshme masën e arrestit ndaj shtetasit A. B., dhe ka vendosur ndaj tij masën e sigurisë “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Denoncuesi ka bërë apel kundërshtues në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

**98.3.** Me urdhrin e datës 05.05.2020, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore lidhur me çështjen nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore, duke u lënë afat deri në datën 15.06.2020. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit ka përcaktuar se është e nevojshme kryerja e këtyre veprimeve hetimore si: të merret akti i ekspertimit mjeko-ligjor; të merret akti i ekspertimit vlerësues; të administrohen tabelat fotografike të vendngjarjes; këqyrjes së personit dhe këqyrjes së aparateve celularë; të pyeten si deklarues punonjësit e policisë; të pyetet viktimja Xh. O.; të pyeten si deklarues persona të cilët kanë dijeni rreth ngjarjes; t’i kërkohen kompanisë celulare tabulatet e komunikimit; si dhe të kryhen veprime të tjera hetimore që do rezultojnë të domosdoshme.

**98.4.** Më datë 11.05.2020, është administruar akti “dëshmi mjeko-ligjore” lidhur me ekzaminimin e viktimës, shtetasit Xh. O., ndërsa në datën 08.06.2020, është administruar raporti i ekspertit të pavarur për kryerjen e ekspertimit ekonomik të dëmit të shkaktuar.

**98.5.** Në datat 17.06.2020, 23.06.2020, 06.07.2020, sipas procesverbaleve të administruara në dosjen e çështjes penale, nga oficerët e policisë gjyqësore janë marrë deklaratimet e disa shtetasve në cilësinë e personit që tregon rrethana të dobishme për qëllimin e hetimit, si dhe në datën 06.07.2020 është marrë në pyetje edhe viktimja. Po në datën 06.07.2020, nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, është përgatitur relacioni për realizimin e detyrave të deleguara nga prokurori i çështjes.

**98.6.** Në datën 30.12.2020, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës shtetasit A. B., si dhe ka urdhëruar delegimin e kryerjes së veprimeve hetimore nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, lidhur me komunikimin e njoftimit të akuzës, pyetjes së të pandehurit dhe komunikimin e aktit të përfundimit të hetimeve për secilin të pandehur, duke mos përcaktuar një datë lidhur me kryerjen e këtyre veprimeve. Vendimi i është komunikuar denoncuesit dhe mbrojtësit të tij, sipas nënshkrimit, më datë 24.02.2021. Po në këtë datë, është marrë në pyetje i pandehuri dhe i është njoftuar përfundimi i hetimeve. Akti i prokurorit për përfundimin e hetimeve i është njoftuar nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, edhe viktimës. Në këtë akt, nuk ka datë se kur është bërë komunikimi, por është vendosur vetëm viti 2021.

98.7. Denoncuesi, nëpërmjet mbrojtësit të tij, ka paraqitur më datë 24.02.2021, kërkesë për marrjen e kopjeve të akteve dhe, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.03.2021, janë dërguar në adresë të mbrojtësit ligjor kopje të akteve të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020.

98.8. Subjekti i rivlerësimit ka marrë tri vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020, përkatësisht në datat 27.07.2020, 27.10.2020 dhe 27.01.2021. Në këto vendime, prokurori ka përcaktuar edhe komunikimin e aktit personave nën hetim dhe mbrojtësve. Nga aktet e fashikullit penal, nuk rezulton që ky komunikim të jetë bërë.

98.9. Më datë 23.03.2021, subjekti i rivlerësimit ka hartuar kërkesën drejtuar gjykatës për gjykimin e procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020, dërguar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.03.2021, si dhe dërguar për njoftim të pandehurve me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.03.2021.

98.10. Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 29.04.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. {\*\*\*}/2020, në ngarkim të të pandehurve D. R. dhe A. B. Në argumentimin e vendimit, gjykata ka vlerësuar se kërkesa i plotëson të gjitha elementet formale të parashikuara nga ligji dhe, në kuadër të vlerësimit të elementeve thelbësore të saj, ka konkluduar se hetimet e kryera nga organi i prokurorisë janë të plota dhe se, në mungesë të kërkesës së palës së interesuar, nuk mundet kryesisht të vlerësojë ekzistencën e pavlefshmërisë relative të akteve.

98.11. Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 21.07.2021, ka vendosur të deklarojë të pafajshëm të pandehurin A. B., për veprën penale të “Prishjes së qetësisë publike”, të parashikuar nga neni 274 i Kodit Penal. Ky vendim është ankimuar nga subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Apelit Vlorë.

99. Nga aktet e administruara, rezulton se denoncuesi, në datat 18.01.2021 dhe 06.04.2021, ka paraqitur ankesë pranë ILD-së, për zvarritje të hetimeve nga subjekti i rivlerësimit, në procedimin penal ndaj tij. Pas shqyrtimit të kërkesës, ILD-ja, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 10.02.2021, ka vendosur për arkivimin e kërkesës së paraqitur nga denoncuesi, pasi ka vlerësuar se, për subjektin e rivlerësimit nuk rezultuan fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit për kryerje të shkeljeve disiplinore, dhe as ndonjë shkelje tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në KLP, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.05.2022, ka vendosur refuzimin e ankesës së z. A. B., kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 10.02.2021, të ILD-së.
100. Nga të dhënat e akteve të mësipërme, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka marrë tri vendime të njëpasnjëshme për zgjatjen me tre muaj të afatit të hetimeve të procedimit penal nr. {\*\*\*}/2020, përkatësisht në datat 27.07.2020, 27.10.2020 dhe 27.01.2021. Në këto vendime, prokurori ka përcaktuar edhe komunikimin e aktit personave nën hetim dhe mbrojtësve. Nga aktet e fashikullit penal, nuk rezulton të jetë dokumentuar që ky komunikim është bërë. Për sa i përket argumentimit të zgjatjes së afatit të hetimeve, subjekti i rivlerësimit, në vendimet e datave 27.07.2020 dhe 27.10.2020, është shprehur se: *në lidhje me këtë procedim penal, janë kryer veprimet hetimore të mësipërme, ndërsa del si domosdoshmëri kryerja e veprimeve të tjera hetimore, të nevojshme për hetimin e këtij procedimi*, por pa cituar se cilat janë këto veprime. Ndërsa, në vendimin e datës 27.01.2021, subjekti i rivlerësimit, në ndryshim nga sa konstaton Komisionerja Publike, ka arsyetuar se: *Në lidhje me këtë procedim penal, janë kryer veprimet*

*hetimore të mësipërme, ndërsa del si domosdoshmëri kryerja e veprimeve të tjera hetimore, të nevojshme për hetimin e këtij procedimi, si komunikimi i akuzës, pyetja e të pandehurve dhe njoftimi i përfundimit.*

101. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, për periudhën nga data 06.07.2020 deri më datë 30.12.2020, për më shumë se 5 muaj, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për përfundimin e hetimit të çështjes, pavarësisht se në vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve ka argumentuar se këto zgjatje janë bërë me qëllim kryerjen e veprimeve të tjera hetimore. Në kuptim të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, “Veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit”, që parashikon: “1. Pasi kryen veprimet e nevojshme hetimore, policia gjyqësore i dërgon aktet prokurorit, bashkë me një relacion shpjegues për faktin dhe provat, si dhe me sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve. 2. Prokurori, pasi shqyrton aktet dhe sigurohet që i pandehuri ose mbrojtësi është njohur me to, vendos, sipas rastit, pushimin e çështjes ose dërgimin e saj në gjykatë”, pas dërgimit prej Oficerit të Policisë Gjyqësore më datë 06.07.2020, të relacionit për dokumentimin e veprimeve hetimore lidhur me këtë procedim penal, periudha 5-mujore deri më datë 30.12.2020, duket e paarsyeshme për të vendosur nëse personi duhet të merret si i pandehur. Këto zvarritje të veprimeve hetimore dhe procedurale nga subjekti i rivlerësimit kanë sjellë për pasojë dërgimin me vonesë në gjykatë të kërkesës për gjykimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit, më datë 23.03.2021, në kushtet kur edhe vendimi i fundit për zgjatjen e afatit të hetimeve, i datës 27.01.2021, parashikonte vetëm kryerjen e disa veprimeve formale për pyetjen dhe njoftimin e të pandehurve.
102. Për sa i përket konstatimit të Komisioneres Publike për mosnjoftimin e akteve për shtyrjen e hetimeve, nga të dhënat e akteve të administruara nga Komisioni, trupit gjykues i rezulton se personi nën hetim dhe mbrojtësi i tij janë njoftuar vetëm për përfundimin e hetimeve, si dhe për komunikimin e akuzës. Nga aktet e administruara për këtë procedim penal, trupit gjykues nuk i rezulton që të jetë bërë njoftimi i personit nën hetim, mbrojtësit të tij ligjor, apo viktimës, për zgjatjen e afateve të hetimit nga prokurori i çështjes, në zbatim të detyrimit që ka pasur ky i fundit për njoftimin e akteve, sipas pikës 3, të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se, vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe viktimës. Për pasojë, trupi gjykues vlerëson se personit nën hetim i është mohuar edhe ushtrimi i së drejtës ligjore të ankimit ndaj vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve, sipas parashikimeve të nenit 325 të Kodit të Procedurës Penale.
103. Në përfundim të analizës së këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi të natyrës organizative për të kryer në mënyrë të efektshme veprimet hetimore, si dhe nuk ka respektuar dispozitat procedurale për njoftimin e akteve palëve. Këto mangësi afektojnë nënindikatorët e parashikuar nga neni 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhet të vlerësohen për peshën e tyre në analizën e përgjithshme të konkluzioneve të trupit gjykues, për sa i përket kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
104. Në përfundim, në lidhje me shkaqet e ankimit të ngritura nga Komisionerja Publike për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, e të mbështetura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, trupi gjykues, nga analizimi i akteve të çështjeve penale të lidhura me denoncimet e shtetasve A. S. dhe A. B., bazuar në indikatorët vlerësues të parashikuar nga nenet 71, 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vëren se konstatohen

mangësi në veprimtarinë e tij si prokuror. Konkretisht, subjekti i rivlerësimit ka mangësi në drejtim të: i) aftësive për të ndërmarrë logjikisht hetimin dhe për të mbledhur provat, si dhe ii) të aftësive organizative për të kryer në mënyrë të efektshme veprimet hetimore, justifikimin e nevojës për zgjatje të afateve hetimore, dhe veprimeve që do të kryhen brenda periudhës së shtyrë, përfshirë njoftimin e palëve lidhur me këto akte. Në vlerësimin e trupit gjykues, këto mangësi, në tërësinë e tyre, nuk konsiderohen të mjaftueshme për t'u kualifikuar sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por u mbajtën në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

105. Trupi gjykues çmon se, sjellja e subjektit të rivlerësimit në drejtim të: i) problematikave të konstatuara për kontratën e energjisë elektrike; ii) pasqyrimin të të dhënave të pavërteta në aplikimin për kredinë e butë nga programet sociale të strehimit, e vijimit të procedurave lidhur me të, edhe pse nuk plotësonte kriteret sipas legjislacionit të kohës, lidhur me nivelin e të ardhurave për përfitimin e kësaj kredie; iii) përdorimit të automjeteve në pronësi të personave të tretë, duke evituar deklarimin e këtyre marrëdhënieve; si dhe iv) problematikave të evidentuara në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale – tregon një vijë sjelljeje të papërshtatshme, jashtë ushtrimit të funksionit të magjistratit, i cili duhet të kujdeset që, me sjelljen e tij, të qëndrojë i pandikuar nga interesat e tij personale apo financiare, dhe të mos pranojë favorizime nga palë të treta, që mund të kenë ndikim në integritetin e paanësinë e tij, në konsideratë të parashikimeve mbi sjelljen e prokurorit në aktet ndërkombëtare<sup>22</sup>, si dhe të Rregullave mbi Etikën dhe Sjelljen e Prokurorit,<sup>23</sup> miratuar me Urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se shkeljet si referuar më sipër, në sytë e një vëzhguesi të jashtëm përbëjnë mjaftueshëm një bazë të dhënash, mbi të cilën konkludohet se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke bërë të zbatueshëm, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pikën 5 të nenit 61 të këtij ligji, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
106. Përfundimisht, në analizë të problematikave të konstatuara, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Genci Mane gjendet i papërshtatshëm për të vijuar detyrën. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 598, datë 13.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i pabazuar në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

<sup>22</sup> Udhëzimet e Budapestit mbi Sjelljen dhe Etikën e Prokurorëve Publikë, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm më 31 maj 2005, pjesët II dhe IV mbi sjelljen profesionale dhe private.

<sup>23</sup> Në nenin 3, shkronja “ë” të këtij urdhri parashikohet se prokurorët duhet: “...Të jenë ...të ndërgjegjshëm për detyrimet etike e profesionale dhe të veprojnë në atë mënyrë që të nxisin besimin e publikut në dinjitetin, integritetin dhe ndershmërinë e tyre”; ndërsa në nenin 8, shkronja “d”: “Të tregojnë sjellje dhe qëndrim korrekt, edhe jashtë sferës së tyre profesionale, për të mos shkaktuar dyshim për ndershmërinë e tyre profesionale”.

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 598, datë 13.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Genci Mane.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 29.07.2025, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*